

## GENTRIT SMAKAJ

The British School of Kosova  
gentrit.smakaj@gmail.com

### KOMITETI “BASHKIM DHE PËRPARIM” DHE SHQIPTARËT NË VITET 1908-1912

#### Abstrakt:

*Artikulli synon të japë një vështrim të përgjithshëm rreth Komitetit “Bashkim dhe Përparim” dhe shqiptarëve gjatë viteve 1908-1912, si dhe të paraqesë rolin dhe kontributin e elitës politike osmane me origjinë shqiptare në themelimin e Komitetit dhe në lëvizjen xhonturke. Në këtë punim identifikohen dhe pasqyrohen pikëpamjet e ndryshme dhe elementet që i bashkonin intelektualët shqiptarë dhe Turqit e Rinj, në veçanti do të analizohen faktorët kryesorë të cilët ndikuan që shqiptarët të rreshtoheshin në mbështetje të lëvizjes xhonturke. Përpos trajtimit të faktorëve ndikues do të analizohen dhe do të interpretohen divergjencat mes shqiptarëve dhe xhonturqve, të cilat ishin produkt i mosmbajtjes së premtimeve nga ana e xhonturqve që shkaktuan ndarjen e rrugëve mes shqiptarëve dhe xhonturqve pas vitit 1908. Në bazë të burimeve osmane, turke dhe shqiptare, punimi do të fokusohet në politikat centraliste dhe osmanizimit e cila ishte zbatuar nga unionistët. Gjithashtu, çështja e alfabetit që ishte objekt debati midis unionistëve dhe shqiptarëve, me theks të veçantë pikëpamjet e Komitetit “Bashkim dhe Përparim” mbi alfabetin e gjuhës shqipe, si dhe kryengritjet shqiptare dhe qëndrimet e burokracisë osmane përballë këtyre zhvillimeve.*

#### Fjalë kyçe:

Shqipëria, shqiptarët, Porta e Lartë, xhonturqit, Komiteti “Bashkim dhe Përparim”.

#### Hyrje

Ideja e monarkisë kushtetuese filloi të diskutohej hapur nga intelektualët osmanë në mesin e viteve '60 të shek. XIX.<sup>1</sup> Monarkia e

---

<sup>1</sup> Ebuzziya Tevfik, *Yeni Osmanlılar Tarihi*, C. I., Çeviren: Ziyad Ebuzziya (İstanbul: Kervan Yayınları, 1973), 77; Tevfik Çavdar, *İttihat ve Terakki* (İstanbul: İletişim

parë kushtetuese u shpall më 23 dhjetor 1876 nën udhëheqjen e Mit'hat Pashës.<sup>2</sup> Por pas disfatës në luftën osmano-ruse, Sulltan Abdyl Hamiti II (1876-1909) e shfuqizoi kushtetutën dhe e shpërndau Parlamentin më 14 shkurt 1878 për një kohë të pacaktuar.<sup>3</sup>

Shfuqizimi i kushtetutës nga Sulltan Abdyl Hamiti II, shpërndarja e Parlamentit dhe krijimi i një administrate të bazuar në autoritetin e tij personal shkaktuan reagimin e intelektualëve osmanë që ishin prokushtetues.<sup>4</sup> Grupi i parë i opozitës së organizuar kundër Sulltan Abdyl Hamitit II u formua në maj ose qershor të vitit 1889, siç ka theksuar historiani i njohur turk Tarık Zafer Tunaja në momentin e 100-vjetorit të Revolucionit Frëng.<sup>5</sup> Me fjalë të tjera, ndërsa festohej njëqindvjetori i Revolucionit Francez, u hodhën themelet e një revolucioni tjetër, Revolucionit Xhonturk që do të rrëzonte regjimin hamidian.<sup>6</sup> Katër studentë të Kolegjit Mjekësor Ushtarak themeluan *İttihad-i Osmanı Cemiyeti* (Shoqëria Osmane për Bashkim), e cila synonte ta rivendoste Kushtetutën e Mit'hat Pashës së vitit 1876.<sup>7</sup> Themeluesit ishin: Ibrahim Temo, një shqiptar nga Struga, Mehmet Reshit, një çerkez nga Kaukazi, Abdullah Xhevdet dhe Ishak Sukuti, dy

Yayınları, 1991), 10; shih edhe: Şerif Mardin, *Yeni Osmanlı Düşüncesinin Doğuşu* (İstanbul: İletişim Yayınları, 2017); Niyazi Berkes, *Türkiye'de Çağdaşlaşma*, Yayına Hazırlayan Ahmet Kuyaş (İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2002); M. Şükrü Hanioglu, "Meşrutiyet", *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (Ankara: TDV yayınları, 2004), 29: 388-393.

<sup>2</sup> Suna Kili, A. Şeref Gözübüyük, *Türk Anayasa Metinleri (Sened-İltifaktan Günümüze)*, Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları (İstanbul: 2000), 41-55.

<sup>3</sup> Yılmaz Öztuna, *II. Abdülhamid Zamanı ve Şahsiyeti*, Ötüken Neşriyat (İstanbul: 2017), 55.

<sup>4</sup> Rezart Mezani, *İttihat ve Terakki, Arnavutlar ve Arnavutluk*, Ege Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü (Tezë Masteri) (İzmir: 2003), 68.

<sup>5</sup> Tarık Zafer Tunaya, *Türkiye'de Siyasi Partiler (1859-1952)* (İstanbul: Doğan Kardeş Basımevi, 1952), 104. Nga ana tjetër, Ramsaur-i tërheq vëmendjen me fillimin e shërbimit të parë të trenit midis Parisit dhe Stambollit një vit më parë (1888); Ernest E. Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*, Türkçesi: Muhsin Önal Mengüşoğlu (İstanbul: Pınar Yayınları, 2011), 33; Kurse në lidhje me këtë çështje, Sina Akşin mbron tezën e Tarık Zafer Tunajës. Sina Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, İmge kitabevi (Ankara: 2014), 49.

<sup>6</sup> François Georgeon, *Sultan Abdülhamid*, Çevirmen: Ali Berktaş (İstanbul: Homer yayınları, 2006), 303.

<sup>7</sup> Orhan Koloğlu, *Abdülhamit Gerçeği* (İstanbul: Pozitif yayınevi, 2021), 484-487.

kurdë përkatësisht nga Arabkiri dhe Dijarbakiri.<sup>8</sup> Në disa burime shtohet edhe një emër i pestë – ai i Husejnzade Aliut nga Baku.<sup>9</sup>

Ibrahim Temo luajti një rol shumë të rëndësishëm në pranimin e njerëzve që donin të anëtarësoheshin në Komitetin “Bashkim dhe Përparim”. Temo filloi të hapte degë në qytetet e mëdha të Rumanisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë.<sup>10</sup> Ai shtypi dhe shpërndau një traktat të quajtur “lëvizja”. Ky traktat, i përbërë nga 93 faqe dhe i botuar si litografi me bojë të kuqe, tërhoqi vëmendje të madhe të xhonturqit.<sup>11</sup> Në këtë traktat shpjegohen humbjet e pësura që nga fillimi i sundimit të Sulltan Abdyl Hamitit II dhe u bë opozita e parë e rëndësishme në Ballkan.<sup>12</sup> Temo i përkiste krahut të lëvizjes xhonturke që përkrahte aksione të ndryshme, madje edhe aksione të armatosura revolucionare. Por, siç kuptohet nga dokumentet e gjetura në Arkivin Qendror të Republikës së Shqipërisë, ishte e nevojshme të luftohej jo vetëm me armë, por edhe me penë kundër regjimit të Sulltan Abdyl Hamitit II.<sup>13</sup> Po ashtu, kjo luftë duhej kuptuar edhe nga rinia.<sup>14</sup> Sepse tashmë fati i Perandorisë Osmane ishte në duart e

<sup>8</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 19, Dosja (më tej: D.) 1, Temo/19; Ibrahim Temo, *İttihat ve Terakki Anılarım* (İstanbul: Alfa yayınlari, 2013; Kristaq Prifti, *Doktor İbrahim Temo: Jeta dhe Vepra 1865-1945* (Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 1996).

<sup>9</sup> Ahmet Bedevi Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler* (İstanbul: Kaynak yayınlari, 2000), 45; Sina Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki* (Ankara: İmge kitabevi, 2014), 49; Ka një debat se kush e themeloi Komitetin e “Bashkimit dhe Përparimit”. Për këtë shih: Mehmet Şükrü Hanioglu, *Bir Siyasal Örgüt Olarak Osmanlı İttihad ve Terakki Cemiyeti ve Jön Türklük (1889-1902)* (İstanbul: İletişim Yayınları), 1985; Tarık Zafer Tunaya, *Türkiye’de Siyasi Partiler (1859-1952)* (İstanbul: Doğan Kardeş Basımevi, 1952); Ahmet Bedevi Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler* (İstanbul: Kaynak yayınlari, 2000); Sina Akşin, *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*, İmge kitabevi (Ankara: 2014); Ernest E. Ramsaur, *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu* (İstanbul: Pınar Yayınları, 2011).

<sup>10</sup> Stanford J. Shaw ve Ezel Kural Shaw, *Osmanlı İmparatorluğu Ve Modern Türkiye, Cilt 2. Reform, Devrim ve Cumhuriyet: Modern Türkiye’nin Doğuşu 1808-1975* (E Yayınları, 2010), 310.

<sup>11</sup> M. Şükrü Hanioglu, “İbrahim Temo (1865-1945) İttihat ve Terakkî Cemiyeti kurucularından Osmanlı siyaset adamı”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (İstanbul: TDV yayınlari, 2000), 21: 354-355.

<sup>12</sup> M. Şükrü Hanioglu, *Bir Siyasal Örgüt Olarak İttihat ve Terakki Cemiyeti ve Jön Türklük (1889- 1902)*, c.I (İstanbul: İletisim Yayınları, 1989), 200.

<sup>13</sup> *AQSH*, F. 19, D. 32/1 (1899), fl. 141. Një letër e panëshkruar drejtuar Ibrahim Temos.

<sup>14</sup> *Po aty*.

të rinjve dhe për këtë arsye të gjitha shpresat qëndronin tek të rinjtë.<sup>15</sup> Lidhur me këtë çështje, Zija Shakir shkruan:

“Këta të rinj, të frymëzuar nga zelli dhe entuziazmi i Mit’hat Pashës, Namık Kemal beut dhe Zija Pashës, i shikonin si heronj të rinjtë osmanë të mbledhur në Evropë gjatë sundimit të Sulltan Abdylazizit dhe mendonin se mund të shpëtonin vendin nga shtypja dhe tirania vetëm duke ecur në gjurmët e tyre”.<sup>16</sup>

Nga deklaratat e Zija Shakirit kuptojmë se ideja dhe qëllimi kryesor ishte t’i jepej fund tiranisë dhe të fitohej liria.

Komiteti “Bashkim dhe Përparim” fillimisht u fokusua vetëm në zhvillimin e Perandorisë Osmane, në kuadër të kushtetutës, osmanizmit dhe programit të lirisë.<sup>17</sup> Në një letër dërguar Ibrahim Temos thuhej se synimi kryesor i unionistëve ishte realizimi i qëllimeve të tyre revolucionare (“Liri, Barazi, Vëllazëri”) dhe vendosja e një qeverie që i shërbente popullit.<sup>18</sup> Xhonturqit synonin të sillnin monarkinë kushtetuese përmes Komitetit “Bashkim dhe Përparim”. Ata shpresonin se duke vendosur një administratë kushtetuese, Perandoria Osmane do të dilte nga situata e vështirë në të cilën ndodhej.<sup>19</sup> Sipas unionistëve, monarkia kushtetuese ishte e vetmja rrugë shpëtimi për Perandorinë Osmane. Me vendosjen e sistemit kushtetues, shtetet europiane, të cilat përdorën si justifikim të drejtat e pakicave dhe ndërhynin në punët e Perandorisë, nuk mund të ndërhynin më në punët e brendshme të shtetit osman.<sup>20</sup>

Pasiguria për të ardhmen e Perandorisë Osmane i la intelektualët shqiptarë përballë domosdoshmërisë së përgatitjes për pavarësi. Prandaj, bashkimi i rajoneve ku jetonin shqiptarët për të formuar një njësi të vetme administrative kishte një rëndësi të madhe për të ardhmen politike të Shqipërisë. Qëllimi politik i intelektualëve shqiptarë ishte që kjo njësi administrative të fitonte autonomi dhe të zhvillohej me reformat që do të kryheshin. Prandaj, rendi kushtetues i synuar nga xhonturqit shihej si një

<sup>15</sup> AQSH, F. 19, D. 31 (1897), fl. 121. Telegram i Ibrahim Temos dërguar princ Sabahaddinit.

<sup>16</sup> Ziya Şakir, *İttihat ve Terakki-I Nasıl Doğdu* (İstanbul: Akıl Fikir Yayınları, 2014), 67.

<sup>17</sup> Dr. Vahid Çabuk, *Sultan II. Abdülhamid* (İstanbul: Paraf yayınları, 2010), 162-163.

<sup>18</sup> AQSH, F. 19, D. 32/1, fl. 26-27 (28 mars 1901).

<sup>19</sup> Vahdettin Engin, *Bir Devrin Son Sultan II. Abdülhamid* (İstanbul: Yeditepe yayınevi, 2017), 286.

<sup>20</sup> Bernard Lewis, *Lindja e Turqisë moderne*, përktheu Krenar Hajdëri (Tiranë: IDK, 2012), 245.

mundësi për intelektualët shqiptarë. Intelektualët shqiptarë ishin të gatshëm të mbështetnin lëvizjen xhonturke, por ata nuk hoqën dorë nga qëllimi politik i përgatitjes së Shqipërisë për pavarësinë e ardhshme.<sup>21</sup> Qëndrimet politike të intelektualëve shqiptarë myslimanë që morën pjesë në lëvizjen xhonturke, u formësuan në kuadrin e një angazhimi dydimensional të bazuar në këtë qëllim politik. Intelektualët me origjinë shqiptare kërkonin ruajtjen e Perandorisë si elementë myslimanë të saj, por njëherësh, ata synonin të arrinin edhe autonominë e Shqipërisë.<sup>22</sup> Megjithatë, xhonturqit e konceptonin shpalljen e kushtetutës, si një përgjigje ndaj zhvillimeve nacionaliste që mund të çonin në shpërbërjen e Perandorisë Osmane. Ata shpresonin se këto zhvillime mund të parandaloheshin me krijimin e një identiteti të ri “osman”. Ky dallim mes pikëpamjeve politike dhe prioriteteve tregoi që në fillim se bashkëpunimi mes palëve do të ishte jetëshkurtër.<sup>23</sup>

### **Komiteti “Bashkim dhe Përparim” dhe shqiptarët, 1907-1912**

Intelektualët shqiptarë morën pjesë aktive në organizata të ndryshme të formuara nga xhonturqit. Ndër personalitetet kryesore shqiptare që kontribuan në lëvizjen xhonturke, ishin: Ibrahim Temo, Dervish Hima, Ismail Qemal, Nexhip Draga, Shahin Kolonja, Mit’hat Frashëri. Këta intelektualë, të cilët ishin aktivë në jetën politike osmane dhe kontribuan ndjeshëm në lëvizjen nacionaliste shqiptare, i dhanë mbështetje aktive edhe lëvizjes xhonturke.<sup>24</sup> Arsytet e mbështetjes së lëvizjes xhonturke nga intelektualët shqiptarë marrin kuptim në kuadrin e pikëpamjeve politike të intelektualëve shqiptarë për të ardhmen e Shqipërisë në këtë periudhë.<sup>25</sup>

Intelektualët shqiptarë i kushtuan rëndësi gjuhës amtare për të mbajtur gjallë kombin e tyre kundër lëvizjeve ndarëse pansllaviste dhe panheleniste në Ballkan. Ata u përpoqën të përhapnin gjuhën shqipe. Në gjysmën e dytë të shek. XIX aplikuan pranë Portës së Lartë për të hapur shkolla në gjuhën shqipe. Meqenëse Porta e Lartë nuk lejoi hapjen dhe

<sup>21</sup> Banu İşlet Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti* (İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2007), 74.

<sup>22</sup> *Po aty.*

<sup>23</sup> *Po aty.*

<sup>24</sup> *Po aty.*, 68.

<sup>25</sup> *Po aty.*

zhvillimin kulturor të shkollave në gjuhën shqipe, intelektualët dhe patriotët shqiptarë iu bashkuan lëvizjes xhonturke.<sup>26</sup> Gjithashtu, kërkesa për bashkimin e krahinave të banuara me shqiptarë u refuzua nga administrata e Sulltan Abdyl Hamitit, me pretendimin se këto dhe kërkesa të ngjashme do të rrisnin kërkesat për decentralizim dhe më pas do të ktheheshin në një Shqipëri të pavarur.<sup>27</sup> Refuzimi i kërkesave të intelektualëve shqiptarë nga administrata e Sulltan Abdyl Hamitit ishte një nga faktorët kryesorë që i shtyu ata të mbështetnin lëvizjen xhonturke.<sup>28</sup> Nacionalistët shqiptarë, ashtu si xhonturqit, besonin se burimi i problemeve ishte administrata e Sulltan Abdyl Hamitit. Në fillim, intelektualët shqiptarë, të cilët mendonin se Shqipëria nuk ishte ende gati për pavarësi, shpresuan se me “*ndryshimin e administratës brutale Abdulhamidike*”, shqiptarëve do t’u jepej autonomia dhe Shqipëria mund të vazhdonte të ekzistonte nën sundimin osman.<sup>29</sup> Për arsye se, siç shkruante në kujtimet e tij Ibrahim Temo, midis disa intelektualëve shqiptarë ekzistonte mendimi se kur xhonturqit të vinin në pushtet si reagim ndaj Abdyl Hamitit, gabimet do të korrigjoheshin dhe më e rëndësishmja, trojet shqiptare do të bashkoheshin në një vilajet të vetëm dhe do t’u jepej autonomia.<sup>30</sup> Nacionalistët shqiptarë mendonin se suksesi i monarkisë kushtetuese nënkuptonte të arrinin ambiciet e tyre që i kishin dëshiruar që nga Kongresi i Berlinit. Megjithatë, osmanizmi, i cili u zhvillua gjatë periudhës së Komitetit “Bashkim dhe Përparim”, nënkuptonte bashkëpunim në një Perandori të centralizuar, por pa autonominë që dëshironin nacionalistët shqiptarë.<sup>31</sup>

Megjithëse Turqit e Rinj ishin kundër formimit të një njësie autonome shqiptare, ata ishin të vetëdijshëm se suksesi i tyre ishte i pamundur pa mbështetjen e popullit shqiptar, të cilët përbënin një pjesë të konsiderueshme të popullsisë myslimane në provincat europiane. Mesazhi i përgjithshëm i Komitetit premtonte një qeverisje kushtetuese,

<sup>26</sup> Mezani, *İttihat ve Terakki*, Tezë Masteri, 72.

<sup>27</sup> Cezmi Eraslan, “Osmanlı Devletinin Arnavutlara Yönelik Politikalarında Birinci ve İkinci Meşrutiyet Dönemlerinin Karşılaştırılması”, *Güneydoğu Avrupa Araştırmaları Dergisi*, Sayı: 13 (2014), 61-62.

<sup>28</sup> Falma Fshazi, “2. Meşrutiyet ve Arnavutluk’taki Osmanlı Algısı: Arnavutlarla Osmanlı’nın Düşman Olduğu O An”, *İstanbul Üniversitesi Siyasal Bilgiler Fakültesi Dergisi*, Sayı: 38 (2008), 170.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> İbrahim Temo, *İttihat ve Terakki Anılarım* (İstanbul: Alfa yayınları, 2013).

<sup>31</sup> S. J. Shaw, E. K. Shaw, *Osmanlı İmparatorluğu Ve Modern Türkiye*, 344-345.

shkarkimin e zyrtarëve të korruptuar e shtypës dhe mbrojtjen e shoqërisë nga intrigat austriake dhe italiane. Në këto përpjekje, Komiteti konfirmoi atë që Abdyl Hamiti e dinte prej tridhjetë vjetësh: shqiptarët ishin shtylla kryesore e Perandorisë në Rumeli dhe çdo zhvillim domethënës kërkonte mbështetjen e tyre në njëfarë mënyre.<sup>32</sup>

Më 3 korrik të vitit 1908 ngriti krye reparti ushtarak i Resnjës, i komanduar nga oficeri shqiptar, Nijazi Beu.<sup>33</sup> Kryengritja e Nijazi Beut u pasua nga ajo e majorit turk, Enver Beut, që shpërtheu në Demir Hisar dhe ajo e shqiptarit tjetër nga Ohri, Ejup Sabri Beut, pikërisht në qytetin e tij në Ohër.<sup>34</sup> Ndërkohë, grupet e armatosura të Çerçiz Topullit dhe Mihal Gramenos, të cilët luftonin prej kohësh në Shqipërinë e Jugut, u bashkuan me Nijazi Beun, i cili filloi Revolucionin Xhonturk.<sup>35</sup> Nga takimi në Pogradec, njerëzit e Nijazi Beut u shfaqën si përkrahës të çdo lloj kompromisi dhe pranuan kërkesat e shqiptarëve për autonomi.<sup>36</sup>

Porta e Lartë e dërgoi gjeneralin e njohur, Shemsi Pasha,<sup>37</sup> për ta shtypur lëvizjen xhonturke, por ai, sapo mbërriti në Manastir me vendimin e Komitetit të Manastirit të “Bashkim dhe Përparimit” më 7 korrik 1908, vritet.<sup>38</sup> Atentatin e kreu Atif Beu, që i përkiste Armatës III të Maqedonisë.<sup>39</sup> Ibrahim Temo e quajti Atif Beun “Hero të Revolucionit”. Vrasja e Shemsi Pashës pati një ndikim të madh te Sulltan Abdyl Hamiti. Sulltani për këtë situatë e pyeti Hysejin Hilmi Pashën, inspektorin e ushtrisë së Selanikut dhe rrethinave të tij: “Kush janë këta unionistë?” Hilmi Pasha iu përgjigj në mënyrë të rafinuar: “Asnjë nga

<sup>32</sup> George W. Gawrych, *Hilal ve Kartal; Osmanlı Yönetimi, İslam ve Arnavutlar 1874-1913*, çeviren, Ali Fahri Doğan (İstanbul: Selenge Yayınları, 2021), 186.

<sup>33</sup> Resneli Niyazi, *Hürriyet Kahramanı Resneli Niyazi Hatıratı - Hâtırat-ı Niyazi* (Ankara: Panama yayıncılık, 2017), 100.

<sup>34</sup> Gentrit Smakaj, “Kontributi i një shqiptari nga Ohri në revolucionin xhonturk”, revista *Shenja* (maj 2020).

<sup>35</sup> Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar* (İstanbul: Büke Kitapları, 2004), 97.

<sup>36</sup> Peter Bartl, *Millî Bağımsızlık Hareketleri Esnasında Arnavutluk Müslümanları 1878-1912*, çeviren, Ali Taner (İstanbul: Bedir Yayını, 1998), 264.

<sup>37</sup> Müfit Şemsi, *Şemsi Paşa, Arnavudluk ve İttihad-Terakki* (İstanbul: Nehir Yay. 1995), 88.

<sup>38</sup> Bernard Lewis, *Modern Türkiye'nin Doğuşu*, Ankara, Türk Tarih Kurumu (Ankara: 1991), 206; Hakan Özdemir, *Abdülhamid'i Deviren Kurşun* (İstanbul: Timaş Yayınları, 2014), 174-176.

<sup>39</sup> Talha Burak Ünlü, *İttihatçı Bir Fedai: Mülazım Atıf Kamçıl* (İstanbul: Timaş Yayınları, 2021).

shërbëtorët tuaj nuk është unionist”.<sup>40</sup> Me këtë përgjigje, ai nënkuptonte se përveç shërbëtorëve të Sulltan Abdyl Hamitit të gjithë të tjerët ishin me Komitetin “Bashkim dhe Përparim”.

Kuvendi i Ferizajt ishte pika më vendimtare e lëvizjes xhonturke dhe pa dyshim që mbështetja më e madhe civile për xhonturqit erdhi nga ky kuvend.<sup>41</sup> Me votimin dhe betimin për realizimin e programit të aprovuar, Kuvendi i Ferizajt më 20 korrik të vitit 1908, i dërgoi sulltanit një telegram ultimativ, duke kërkuar kthimin e Kushtetutës të vitit 1876 dhe ribërjen e Parlamentit. Nga Rumelia në Pallatin e sulltanit, shkonin vazhdimisht qindra telegrame ku kërkohej rishpallja e kushtetutës dhe thirrja e një kuvendi kombëtar.<sup>42</sup> Nën këtë presion, Sulltan Abdyl Hamiti do të binte dakord që më 23 korrik 1908 ta shpallte kushtetutën.<sup>43</sup> Kjo ngjarje shënoi edhe fitoren e Revolucionit Xhonturk të korrikut të vitit 1908, në të cilin shqiptarët dhanë një kontribut të çmuar.<sup>44</sup>

Është shumë e vështirë të flitet për një ideologji të përgjithshme që përfshin të gjithë xhonturqit. Në njëfarë kuptimi, pika e përbashkët e xhonturqve dhe e shqiptarëve ishte pakënaqësia me regjimin e Abdyl Hamitit II dhe dëshira për të përmbytur këtë regjim dhe vendosja e një regjimi të ri kushtetues.<sup>45</sup> Ndërsa intelektualët shqiptarë shpresonin që, kur të rishpallej monarkia kushtetuese, xhonturqit do t’i jepnin Shqipërisë autonomi. Megjithatë, menjëherë pasi Komiteti “Bashkim dhe Përparim” mori pushtetin, ai miratoi politikën centraliste dhe unioniste të Sulltan

<sup>40</sup> İlber Ortaylı ve Erol Şadi Erdinç, *İttihat ve Terakki: Osmanlı İmparatorluğu'nda Gizli Örgütlenmeler ve Darbeler*, Hazırlayan: Alper Çeker (İstanbul, İnkılap Kitabevi, 2016), 53.

<sup>41</sup> Süleyman Kulçe, *Firzofik Toplantısı ve Meşrutiyet* (İstanbul: Kitabevi, 2013).

<sup>42</sup> *Türkiye Cumhuriyeti Cumhurbaşkanlığı Devlet Arşivi Başkanlığı Osmanlı Arşivi* (më tej: BOA), Yıldız Esas Evrakı (Y.E.E) D. 71 G. 68; BOA. Y.E.E. 71/69; BOA. Y.EE. 71/57.

<sup>43</sup> İsmail Hakkı Uzunçarşılı, “II. Meşrutiyet’in Ne şekilde İlan Edildiğine Dair Vesikalar”, *Belâten'den ayrı basım*, Türk Tarih Kurumu yayınları Ankara (1966), 106.

<sup>44</sup> Skënder Rizaj, “Roli i shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të vitit 1908”, *Kosova, Enti i Historisë së Kosovës* (Prishtinë: 1974), 178; Kristaq Prifti, “Kontributi i shqiptarëve në Lëvizjen e Turqve të Rinj (1889-1908)”, në *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike 31-32, 2001-2002 (Prishtinë: 2003): 229-230; Hasan Kaleshi, “Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll”, në *Gjurmime Albanologjike*, 1 (Prishtinë: 1969): 81.

<sup>45</sup> M. Şükrü Hanioglu, “Jön Türkler”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (İstanbul: TDV yayınları 2001), 23: 584-587.



Abdyl Hamitit. Kjo situatë do të çonte në mënyrë të pashmangshme në mosmarrëveshje mes nacionalistëve shqiptarë dhe unionistëve.

Një çështje shumë e rëndësishme që duhet përmendur është se xhonturqit u premtuan disa liri shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Perandorisë Osmane, për të cilën flitet dhe shkruhet në libra të ndryshëm. Është e vërtetë që premtime të tilla ka pasur, por duhet sqaruar se nga kush dhe nga cili grup i Turqve të Rinj janë bërë këto premtime. Nëse këto premtime janë dhënë nga njerëz si Resneli Nijazi Beu e të tjerë, atëherë duhet theksuar se cili ishte roli i Resneli Nijazi Beut pas fitores së Revolucionit të korrikut 1908. Pas vitit 1908, Nijazi Beu dhe përkrahësit e tij nuk kanë pasur asnjë rol dhe në këtë drejtim, premtimet që kanë bërë pas korrikut të vitit 1908 nuk kanë qenë të vlefshme. Cili ka qenë roli i princ Sabahaddinit pas vitit 1908? Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme sepse, para revolucionit të vitit 1908 Ismail Qemali dhe Dervish Hima mbështetën grupin e princ Sabahaddinit, i cili parashikonte decentralizimin në Perandorinë Osmane. Natyrisht, kjo ideologji që ndoqi Sabahaddin Beu ishte diçka që dëshironin nacionalistët shqiptarë. Princ Sabahaddini u kishte premtuar nacionalistëve shqiptarë se do të njihte të drejtat kombëtare të shqiptarëve, nëse ai dhe grupi i tij do të fitonin. Por, në korrik të vitit 1908, situata u përmbys. Princ Sabahaddini dhe grupi i tij nuk mundën ta fitonin luftën e tyre kundër grupit të Ahmet Riza Beut, i cili ishte pro centralizimit të pushtetit perandorak. Siç do të shihet, princ Sabahaddini, Ismail Qemal Beu dhe fisnikët e tjerë shqiptarë do të mbeten në opozitë. Por shtrohet pyetja tjetër, nëse Ahmet Riza Beu u bëri ndonjë premtim shqiptarëve apo popujve të tjerë të Perandorisë? Jo, ai nuk u bëri asnjë premtim! Pse? Sepse ishte për mbrojtjen, centralizimin dhe forcimin e Perandorisë Osmane nën ideologjinë e osmanizmit.<sup>46</sup>

Këtu duhet theksuar se fitorja e revolucionit për masat e mëdha shqiptare nënkuptonte hapjen e shkollave shqipe dhe përdorimin e gjuhës shqipe në administratën lokale, marrjen në dorë të administratës, botimin e librave, gazetave, revistave në gjuhën shqipe dhe kryerjen e shërbimit ushtarak brenda krahinave shqiptare. Prandaj, pas vitit 1908 dallimet në mendime midis shqiptarëve dhe Turqve të Rinj do të rriteshin duke i çuar të dyja palët në një konflikt të armatosur. Natyrisht, pasojë e kësaj do të jenë politikat centraliste dhe osmaniste të zbatuara nga unionistët.

<sup>46</sup> Gëntrit Smakaj, *İttihat ve Terakki ve Arnavut Meselesi (1908-1913)*, Akdeniz Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Tezë Doktrate (Antalya: 2022), 77-78.

Turqit e Rinj ishin përgjithësisht konservatorë dhe nuk kishin synim të përmbysnin sistemin ekzistues qeveritar. Shumica e Komitetit “Bashkim dhe “Përparim” nuk ishte në favor të ndryshimeve shoqërore.<sup>47</sup> Turqit e Rinj e kryen revolucionin në korrik të vitit 1908 për të shpëtuar Perandorinë, që ishte në rrezik të madh. Por, pasi morën në duar frenat e pushtetit, atyre u duhej të vinin në jetë fjalën e parë të parullës së tyre: “bashkim”. Për xhonturqit “bashkim” do të thoshte bashkim i të gjitha elementeve etnike të Perandorisë; pra me këtë hap do t’iu jepej fund të gjitha prirjeve për separatizëm, autonomi ose edhe ndarje nga kombësitë e tjera të Perandorisë, qofshin këto myslimane ose jomyslimane. Turqit e Rinj mendonin, pra, që të mos kishte më grekë, hebrenj, armenë, arabë, shqiptarë, turq, por vetëm qytetarë osmanë të bashkuar, të barabartë para ligjit, që të kishin të njëjtat të drejta dhe të njëjtat detyra. Siç shihet, tek ata jakobinizmi i Revolucionit Francez kishte lënë gjurmë të thella; po ashtu edhe deviza: “Shteti është një dhe i pandarë”. Prandaj Turqit e Rinj kërkonin të centralizonin, të njësonin, të barazonin dhe të racionalizonin.<sup>48</sup>

Si një nënprodukt i sistemit të centralizuar që Turqit e Rinj krijuan, lindi lëvizja e turqizimit.<sup>49</sup> Turqit e Rinj, në programin që përgatitën në kongresin e mbajtur në Selanik, për arsimin, “kërkohej që gjuha e mësimin në shkollat publike të ishte turqishtja. Komiteti, donte ta çonte konstitucionalizmin në një osmanizëm gradual dhe në një administratë të centralizuar. Otomanizmi gradual, “Populli i Perandorisë Osmane do të ishte një tërësi nën emrin e kombit osman, pa dallim race dhe sekti. Një komb, thelbi i të cilit do të ishte turqizmi, Islami do të formonte bërthamën dhe osmanizmi do të formonte guaskën... Sepse dinastia osmane, e cila ishte shtylla e Perandorisë Osmane, ishte turke, ishte komuniteti turk ku ai u mbështet për të mbrojtur sigurinë e tij. Elementi i saj unifikues, pra gjuha zyrtare, u pranua turqishtja me kushtetutë. Elementi i dytë unifikues i Perandorisë Osmane ishte Islami”. Me

<sup>47</sup> Feroz Ahmad, *İttihat ve Terakki 1908-1914*, çeviren: Nuran Yavuz (İstanbul: Kaynak Yayınları, 2016), 41.

<sup>48</sup> Robert Mantran, *Historia e Perandorisë Osmane*, përktheu Asti Papa (Tiranë: Dituria, 2004), 551.

<sup>49</sup> Mezani, *İttihat ve Terakki*, Tezë Masteri, 111; Për një analizë më të mirë, shih: Hasan Kayalı, *Jön Türkler ve Araplar. Osmanlılık, Erken Arap Milliyetçiliği ve İslamcılık 1908-1918*, Çeviren: Türkan Yöney, Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları (İstanbul: 2019), 96-112.

artikullin e Hüseyin Xhahit me titull “*Millet-i Hakime*”, ai shpalo si kuptimin nacionalist të tij dhe të Komitetit “Bashkim dhe Përparim”: “sido që të quhet, ‘kombi sundues’ në vend janë dhe do të jenë turqit”. Ky artikull i shqetësoi shumë jo vetëm elementët jomyslimanë, por edhe elementët myslimanë, përfshi arabët dhe shqiptarët.<sup>50</sup>

Natyrisht, feja ishte e para që u prek nga politika e unionistëve. Pakicat ishin të organizuara në bashkësi fetare. Ato nuk ishin proosmanizëm, siç e përshkruanin unionistët, për shkak të humbjes së privilegjeve të tyre. Një otomanizëm i tillë nënkuptonte fillimisht heqjen e privilegjeve dhe më pas hapjen e rrugës për turqizimin. Myslimanët dhe joturqit ishin kundër kësaj politike po aq sa edhe të krishterët.<sup>51</sup>

Në vitin 1908, situata kishte ndryshuar në mënyrë drastike, si brenda Perandorisë ashtu edhe në botën e jashtme. Brenda, kërcënimet e elementëve joturq për t’u larguar nga Perandoria dhe për të krijuar shtete të pavarura po shtoheshin dita-ditës dhe bashkë me të fuqizohej edhe mundësia e ndërhyrjes së fuqive të huaja.<sup>52</sup> Regjimi i ri përjetoi depresionin e parë të madh në tetor të vitit 1908. Para së gjithash, aneksimi i Bosnjë-Hercegovinës nga Austro-Hungaria dhe në të njëjtën kohë shpallja e pavarësisë së Bullgarisë dhe vendimi i Asamblesë së Kretës për t’iu bashkuar Greqisë krijuan një situatë jashtëzakonisht të vështirë për Perandorinë Osmane dhe elementët osmanë që përbënin këtë Perandori.<sup>53</sup> Këto ngjarje ndikuan që në këtë fazë, shqiptarët të kuptonin se Perandoria Osmane nuk mund t’i mbronte.<sup>54</sup> Turqit e Rinj, të cilët ia atribuonin të gjitha negativitetet administratës së brendshme, u kapën të papërgatitur për këto zhvillime në politikën e jashtme. Efektet e këtyre zhvillimeve në politikën e jashtme u ndien menjëherë brenda dhe bashkëpunimi midis Turqve të Rinj dhe shqiptarëve filloi të përkeqësohej.<sup>55</sup>

<sup>50</sup> *Po aty*, 111.

<sup>51</sup> *Po aty*, 111-112.

<sup>52</sup> Ahmad, *İttihat ve Terakki 1908-1914*, 49.

<sup>53</sup> *Po aty*, 51.

<sup>54</sup> McCarthy, Justin, *Osmanlı'ya Veda / İmparatorluk Çökerken Osmanlı Halkları*, çev. Mehmet Tuncel (İstanbul: Nesil Yayınları, 2006), 280.

<sup>55</sup> Bilgin Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar* (İstanbul: Büke Kitapları, 2004); Banu İşlet Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti* (İstanbul: Yapı Kredi Yayınları), 2007.

*Refektimi i Revolucionit Xhonturk mbi shqiptarët*

Shpallja e monarkisë së dytë kushtetuese më 23 korrik 1908, u prit me gëzim dhe entuziazëm në të gjithë Shqipërinë.<sup>56</sup> Fillimi i regjimit të Komitetit “Bashkim dhe Përparim” i gjeti shqiptarët shumë aktivë. Menjëherë pas shpalljes së kushtetutës, u krijuan klube shqiptare kombëtare në qytetet kryesore të Shqipërisë dhe në disa qendra të tjera të Perandorisë Osmane ku banonin shqiptarë.<sup>57</sup> Brenda një kohe të shkurtër u krijuan shumë klube me emrin “Bashkimi”. Sipas burimeve të ndryshme, vetëm brenda 10 muajve të parë u krijuan 66 klube kulturore dhe politike në krahinat shqiptare. Brenda kësaj periudhe u mbledh Kongresi i Manastirit ose Kongresi i Alfabetit. Gjithashtu, u hapën 24 shkolla të natës me 1 753 nxënës dhe 34 shkolla fillore me 1 850 nxënës.<sup>58</sup> U botuan libra në gjuhën shqipe dhe po ashtu në botën e shtypshkronjës pati një ringjallje dhe disa organe shtypi hynë në marrëdhënie të ngushta me klubet shqiptare dhe siguruan përhapjen e ideve nacionaliste.<sup>59</sup> Klubet me emrin “Bashkimi” ishin më të njohurit dhe më të organizuarit në historinë e klubeve ose shoqërive shqiptare. Synimi i dukshëm i këtyre klubeve ishte mësimi dhe përhapja e gjuhës shqipe.<sup>60</sup>

Menjëherë pas fitores së Revolucionit Xhonturk, doli në plan të parë rihapja e Parlamentit, i mbyllur që në vitin 1878. Zgjedhjet e para të përgjithshme në monarkinë e dytë kushtetuese u mbajtën në nëntor-dhjetor 1908. Zgjedhjet nuk ishin krejt të rregullta. Turqit e Rinj i trembeshin një kundërvëniesje kombëtare të deputetëve joturq, sidomos nga Turqia europiane. Njëpërmjet një ndarjeje të ndërlikuar të rretheve

<sup>56</sup> Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk* (İzmir: Genelkurmay Basımevi, 1944), 352.

<sup>57</sup> Stavro Skëndi, *Zgjidhjet kombëtare shqiptare 1878-1912* (Tiranë: Phoenix Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2000), 313-314.

<sup>58</sup> Bartl, *Milli Bağımsızlık Hareketleri Esnasında Arnavutluk Müslümanları*, 276; Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 211.

<sup>59</sup> Shih: Gentrit Smakaj, “Shtypi shqiptar në epokën e dytë kushtetuese dhe qëndrimi i Portës së Lartë ndaj tij”, në *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike, 52 (Prishtinë: 2022).

<sup>60</sup> İhsan Burak Birecikli, *Arnavutlar ve Arnavutluk Sorunu 1908-1914*, Gazi Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Tez e Doktoratës (Ankara: 2010), 141.

elektorale ata u përpoqën që edhe në rrethet që ishin kryesisht sllave ose shqiptare (veçanërisht në vilajetin e Manastirit), të arrinin të paraqitnin kandidatura turke dhe të pengonin zgjedhjen e kandidatëve të *partisë kombëtare*.<sup>61</sup> Me gjithë ndërhyrjet e administratës policore perandorake, Partia Bashkim dhe Përparim në territoret me popullsi shqiptare nuk pati sukses.<sup>62</sup> Shumica e 26 deputetëve shqiptarë të dalë nga zgjedhjet ishin kundërshtarë xhonturq.<sup>63</sup> Kjo ndodhi për arsye se nacionalistët shqiptarë bënë pjesë në grupet ose partinë kundërshtare të Turqve të Rinj. Në krye të deputetëve shqiptarë, kundërshtarë të xhonturqve, ishin Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina.<sup>64</sup> Në të dhënat zyrtare, shqiptarët u urdhëruan nga krerët e tyre të bashkoheshin me Partinë Liberale (Ahrar).<sup>65</sup> Studiuesi i njohur Aykut Kansu argumenton se nacionalistët shqiptarë mbështetën programin e decentralizimit të zbatuar nga princ Sabahaddini dhe Partia Liberale gjatë zgjedhjeve.<sup>66</sup> Arsyja për këtë ishte se një nga pikat kryesore të programit të saj ishte decentralizimi dhe autonomia për të gjitha kombësitë. Këtu ajo ishte në kontradiktë të fortë me politikën centralizuese xhonturke.<sup>67</sup>

Turqit e Rinj, në fillim, nuk i penguan veprimtaritë e klubeve nacionaliste shqiptare, por ata ngritën në Shqipëri, si kudo në Perandori, qendrën e partisë së tyre, e cila, për të mbrojtur osmanizmin, bënte fushatë kundër nacionalistëve. Si kundërpërgjigje, këta të fundit

<sup>61</sup> Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Përktheu: Nestor Nepravishta (Tiranë: Dituria, 2006), f. 203.

<sup>62</sup> Kristo Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Tiranë: 2008), 56; Përkundrazi, në shkallën perandorake, xhonturqit fituan shumicën. Për këtë shih: Fevzi Demir, *Osmanlı Devleti'nde II. Meşrutiyet Dönemi Meclis-i Mebusan Seçimleri 1908-1914* (Ankara: 2007); Kenan Olgun, *1908-1912 Osmanlı Meclis-i Mebusanı'nın Faaliyetleri ve Demokrasi Tarihimizdeki Yeri* (Ankara: 2014).

<sup>63</sup> Aykut Kansu shkruan se numri i deputetëve shqiptarë ishte 27 dhe shprehet se nga 27 deputetë shqiptarë, vetëm dy ishin unionistë besnikë. Ndërsa dhjetë deputetë ishin në grupin e pavarur, shumica e pesëmbëdhjetë deputetëve monarkistë shqiptarë formonin kuadrot drejtues të partive të ndryshme opozitare. Aykut Kansu, *1908 Devrimi, İletişim* (İstanbul: 2001), 354.

<sup>64</sup> Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, 56.

<sup>65</sup> BOA. Yıldız Esas Evrakı (Y.EE), D. 34. G. 3385.

<sup>66</sup> Aykut Kansu, *1908 Devrimi*, Çeviri: Ayda Erbal (İstanbul: İletişim, 2001), 331.

<sup>67</sup> Në lidhje me këtë shih: Nureddin Ferruh Alkend, *Ahrar Fırkası ve 2. Meşrutiyet Anıları*, Hazırlayan: Ali İhsan Kolcu (İstanbul: Babil, 2017); Oğuz Kaan, *Osmanlı Ahrar Fırkası* (Ankara: Gazi Kitabevi, 2021).

përsërisnin kërkesat e tyre për autonomi, për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe për emërimin e shqiptarëve në poste kyçe në provincë.<sup>68</sup> Por, të shqetësuar nga zhvillimi i shpejtë i lëvizjes kombëtare në Shqipëri, qeveritarët xhonturq sapo siguruan shumicën në Parlament, filluan një politikë të re kundër shqiptarëve. Në mënyrë të veçantë, ata kaluan në reaksion të hapur kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Pa kaluar gjashtë muaj, ata filluan me kërcënime e me presione t'i mbyllnin klubet patriotike e shkollat shqipe. Gjithashtu, ata kaluan në burgime e internime të patriotëve shqiptarë.<sup>69</sup> Me urdhër të qeverisë osmane u mbyllën shumë gazeta dhe klube shqiptare.<sup>70</sup> Turqit e Rinj nuk e vlerësuan se deri në ç'shikallë qe rritur ndjenja kombëtare shqiptare prej krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe, ndërkohë që ata mbeteshin me përshtypjen se ajo do të rezultonte vetëm një mbrojtje ndaj ndërhyrjes së huaj, shqiptarët ndërmorën hapa, për të mbrojtur veten jo vetëm kundër agresorëve të huaj, por edhe kundër çdo përpjekjeje që mund të bënin turqit për ta shtypur sërish këtë lëvizje ose për të kufizuar liritë e tyre të sapovendosura.<sup>71</sup>

Pikëpamjet e intelektualëve shqiptarë për regjimin kushtetues u formësuan në bazë të mundësive që jepte regjimi i ri në drejtim të lëvizjes nacionaliste shqiptare. Motivi i konfliktit, i cili mbeti në plan të dytë në periudhën e parë në marrëdhëniet mes administratës së Komitetit “Bashkim dhe Përparim” dhe shqiptarëve, u evidentua kur çështja e alfabetit u fut në rendin e ditës nga intelektualët shqiptarë dhe shkaktoi konfliktin e parë të hapur midis intelektualëve shqiptarë dhe administratës së këtij Komiteti. Sigurimi i unitetit mes shqiptarëve nëpërmjet një alfabeti standard, ishte një kërkesë e papajtueshme për administratën e “Bashkimit dhe Përparimit”, e cila ishte e vetëdijshme se e vetmja mënyrë për shqiptarët myslimanë për të ruajtur besnikërinë e tyre ndaj Perandorisë ishte duke theksuar identitetin e tyre mysliman. Komiteti “Bashkim dhe Përparim” përfitoi nga reagimi i grupeve konservatore myslimane ndaj gjuhës shqipe e alfabetit latin dhe zhvilloi veprimtari propagandistike në favor të alfabetit arab, i cili ishte simbol i besnikërisë së këtyre grupeve ndaj Perandorisë dhe islamit. Këto nisma të

<sup>68</sup> S. J. Shaw, E. K. Shaw, *Osmanlı İmparatorluğu Ve Modern Türkiye*, 345.

<sup>69</sup> Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, 56.

<sup>70</sup> BOA. Hariciye Nezareti Siyasî Kısmı Belgeleri (HR.SYS), D. 137. G. 6.

<sup>71</sup> Joseph Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, përktheu Kujtim Ymeri (Tiranë: Dituria, 2005), 83.

Komitetit bënë që intelektualët shqiptarë të humbnin besimin te Komiteti dhe ndërkohë të niste një proces i pakthyeshem konflikti mes palëve. Ky proces do të merrte vrull me autoritarizmin e administratës xhonturke pas *incidentit* të 31 marsit dhe zbatimit pa kompromis të politikës së saj centraliste dhe osmaniste.<sup>72</sup>

Politika osmaniste e Komitetit të “Bashkimit dhe Përparimit”, që kishte tendenca turqiste, u zbatua veçanërisht në çështjet e alfabetit dhe të shkollave dhe ishte vendimtare në kundërshtimin e intelektualëve shqiptarë.<sup>73</sup>

*Pikëpamja e Komitetit “Bashkim dhe Përparim”  
mbi çështjen e alfabetit shqip*

Në problemin e gjuhës dhe të alfabetit të diskutuar mes intelektualëve shqiptarë, Porta e Lartë në fillim preferoi t’i linte të lirë shqiptarët që të zgjidhnin në mes alfabetit latin dhe atij arab, por në një mënyrë të kontrolluar në përputhje me rendin kushtetues. Kështu, Porta e Lartë donte ta përjetonte procesin duke marrë parasysh kërkesat e intelektualëve shqiptarë, duke e vlerësuar çështjen në atmosferën e lirisë që solli konstitucionalizmi dhe duke përmbushur pozitivisht kërkesat e elementëve etnikë për çështjen e gjuhës dhe të arsimit.<sup>74</sup>

Por, fakti që nuk kishte konsensus\* në mesin e intelektualëve shqiptarë për këtë çështje, e bëri Portën e Lartë të mendohej më shumë. Të dhënat zyrtare të periudhës zbulojnë qartë vështirësitë e Portës së Lartë në problemin e alfabetit të gjuhës shqipe.<sup>75</sup> Në fakt, një shënim i datës 10 shtator 1908 tregon se shqiptarët kishin preferenca të ndryshme alfabetike në rajonet me shumicë shqiptare. Për shembull, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e Shqipërisë së Mesme dhe asaj Jugore

<sup>72</sup> Sönmez, *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*, 119.

<sup>73</sup> *Po aty*, 201.

<sup>74</sup> BOA, *Bâbîâli Evrak Odası (BEO)*, 4056/304168, Receb sene 1330 (Haziran 1912).

\* Çështja e alfabetit kombëtar të gjuhës shqipe kishte shkaktuar disa përçarje në shoqërinë shqiptare, për shkak të mendimeve të ndryshme mes shqiptarëve dhe nuk ishte arritur një përfundim në vlerësimin e alfabetit që do të përdorej në shkollat shqipe. Kjo ishte edhe arsyeja e organizimit të Kongresit të Manastirit, në nëntor të vitit 1908.

<sup>75</sup> BOA, *Rumeli Müfettişliği Makamât Evrakı (TFR.I.MKM)*, 32/ 3101, 13 Şaban 1326 (10 Eylül 1908).

preferonte shqipen me alfabet latin, kuptohej se në rajone të tjera, si në Kosovë, preferohej alfabeti arab (osman).<sup>76</sup> Porta e Lartë dhe sidomos administrata e “Bashkimit dhe Përparimit” bëri një propagandë që shoqëria shqiptare të preferonte alfabetin arab. Në lidhje me këtë çështje, Peter Bartl pohon: “Xhonturqit nuk kishin nevojë që të luftonin haptazi kundër alfabetit latin, gjë që do të ishte në kontradiktë me karakterin ndërfetar të revolucionit të tyre, por vetëm mbështetën myslimanët shqiptarë të zhvillonin një agjitacion islamik. Klerikët myslimanë e shpjegonin përdorimin e alfabetit latin si një shenjë të daljes, shkëputjes nga islamizmi dhe një sakrilegj për myslimanët ka vetëm një alfabet, ai i Kuranit”.<sup>77</sup> Por, duhet theksuar se kishte klerikë të tillë si Hafiz Ali Korça të cilët përkrahën alfabetin latin.<sup>78</sup>

Në kongresin e mbledhur në Manastir në nëntor të vitit 1908, edhe pse nuk pati konsensus për një alfabet të vetëm, megjithatë u arrit konsensus për përdorimin e dy alfabeteve me bazë latine. Por, pas një kohe, Komiteti “Bashkim dhe Përparim” i mbylli këto klube dhe shkolla dhe ndaloi botimet në gjuhën shqipe. Xhonturqit filluan t’i shihnin shqiptarët si “tradhtarë” për shkak të lëvizjeve të tyre nacionaliste dhe si bashkëpunëtorë e përkrahës të Sulltan Abdyl Hamitit II. Shqiptarët, të cilët mendonin se xhonturqit po rrëshqisnin nga themelet e monarkisë kushtetuese, i dhanë një shtysë më shumë idesë së tyre për pavarësi, madje filluan sërish kryengritjet.<sup>79</sup>

Duke i hequr shqiptarët nga arsimimi në gjuhën e tyre, këtë të drejtë e kishin popujt grekë, bullgarë, armenë, serbë, hebrenj e të tjerë. Gjithashtu, duhet theksuar se këta popuj këto të drejta i gëzonin në territoret e shtetit osman, pra edhe në territoret shqiptare. Si për shembull në territoret shqiptare jugore, numri i shkollave greke ishte më i madh se i atyre osmane. Ideja e turqizimit të tyre mund të parashtrohet nga disa intelektualë osmanë si një politikë e zbatueshme dhe legjitime. Një nga arsyet më të rëndësishme që i largoi intelektualët shqiptarë nga Komiteti

<sup>76</sup> BOA, *Rumeli Müfettişliği Makamât Evrakı (TFR.I.MKM)*, 32/ 3101, 13 Şaban 1326 (10 Eylül 1908).

<sup>77</sup> Bartl, *Milli Bağımsızlık Hareketleri Esnasında Arnavutluk Müslümanları*, 281.

<sup>78</sup> Për këtë shih: Nuridin Ahmeti, *Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Instituti Albanologjik (Prishtinë: 2017), 278-286.

<sup>79</sup> Fahri Maden, “Arnavutluk’un Bağımsızlık Süreci (1878-1913)”, *Avrasya Etütleri*, 38 (2011), 164.



“Bashkim dhe Përparim”, ishte pikërisht ndalimi i arsimimit në gjuhën e tyre dhe me shkronjat që dëshironin.<sup>80</sup>

Pavarësisht se Kongresi i Manastirit u mbledh për një çështje në dukje teknike, siç ishte unifikimi i alfabetit, ai diskutoi edhe për çështjen e njohjes së kombit shqiptar nga xhonturqit. Në rrethanat historike dhe politike të kohës, çështja e alfabetit bëri që të lindte konflikti i fshehtë midis intelektualëve shqiptarë dhe xhonturqve. Historiani i njohur Feroz Ahmad, ka theksuar se vendimet që u morën në Kongresin e Manastirit ishin në kundërshtim me qëllimet e Turqve të Rinj për të bashkuar Perandorinë Osmane.<sup>81</sup> Sipas historianit Ahmad, duke përdorur islamin si një mjet, Stambolli filloi një propagandë intensive në favor të alfabetit osman.<sup>82</sup>

Komiteti “Bashkim dhe Përparim” çështjen e gjuhës dhe të arsimit e konsideronte si bazën e politikës së ndarjes nga Perandoria ose si një nga metodat e prishjes së unionit osman. Prandaj, ndërhyrja ndaj shqiptarëve në çështjen e alfabetit e të gjuhës dhe rekomandimi i alfabetit arab në vend të alfabetit latin buronte nga një shqetësim i tillë. Xhonturqit u përpoqën të popullarizonin gjuhën shqipe me alfabetin arab në shkollat shqipe dhe kështu të shmangnin zhvillimin e një lëvizjeje kombëtare nëpërmjet alfabetit latin të shqiptarët. Kryeministri i qeverisë osmane, Ibrahim Hakki Pasha është shprehur se “çështja e alfabetit shqiptar ka një karakter politik e kombëtar dhe qeveria nuk do të lejojë të ndahet Shqipëria nga shteti osman”. Pra, sipas tij, qeveria e shihte miratimin e shkronjave latine si hapin e parë të shqiptarëve për t’u shkëputur nga Perandoria Osmane. Veziri i Madh, Ibrahim Hakki Pasha theksoi se qeveria duhet dhe do të bëjë gjithçka për të parandaluar miratimin e alfabetit latin.<sup>83</sup>

Mosbesimi i intelektualëve shqiptarë ndaj administratës së unionistëve u shtua me përpjekjet e këtyre të fundit për çështjen e alfabetit dhe marrëdhëniet në mes të nacionalistëve shqiptarë dhe unionistëve u tensionuan edhe më tepër. Ndërsa Porta e Lartë shqetësohej, shumë nga kërkesat kulturore dhe arsimore të shqiptarëve

<sup>80</sup> Çelik, *İttihatçılar ve Arnavutlar*, 118.

<sup>81</sup> Feroz Ahmad, *Jön Türkler ve Osmanlı Milletler; Ermeniler, Rumlar, Arnavutlar, Yahudiler ve Araplar*, çeviren: Ayşen Gür, İstanbul Bilgi Üniversitesi Yayınları (İstanbul: 2017), 77.

<sup>82</sup> *Po aty*.

<sup>83</sup> *Po aty*, 77-78.

ishin gjithashtu politike. Kjo situatë solli natyrshëm që unionistët dhe Porta e Lartë t'iu kundërviheshin shqiptarëve. Fakti që kishte një dallim të thellë mendimesh mes shqiptarëve për çështjen e alfabetit dhe të arsimit, ndikoi shumë në politikën e Portës së Lartë.

*Polarizimet e theksuara mes Komitetit “Bashkim dhe Përparim” dhe shqiptarëve, 1908-1912*

Ndërmjet viteve 1908 dhe 1912, në Shqipëri u zhvilluan katër kryengritje. Megjithëse shqiptarët luajtën një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e lëvizjes xhonturke, në themelimin e Komitetit “Bashkim dhe Përparim” dhe ndihmuan në shpalljen e kushtetutës, ata i humbën shpresat se nën qeverisjen xhonturke mund t'i fitonin të drejtat kombëtare. Shqiptarët nuk i përvetësuan idetë e Komitetit të “Bashkimit dhe Përparimit” se në Perandorinë Osmane nuk kishte turq, bullgarë, armenë, arabë apo shqiptarë dhe të gjithë ishin qytetarë të lirë me të drejta dhe detyra të barabarta sipas kushtetutës.<sup>84</sup> Ata përsërisnin vazhdimisht se donin të mbeteshin shqiptarë dhe se synonin ta bënë Shqipërinë të lirë.<sup>85</sup> Ishte revolta shqiptare ajo që, më shumë se çdo ngjarje tjetër, i bindi Turqit e Rinj se ishte e pamundur që të pajtonin interesat e ndryshëm kombëtarë dhe ta mbanin të bashkuar Perandorinë.<sup>86</sup>

Administrata e re ndonjëherë dërgonte si administratorë në Shqipëri njerëz të papërvojë dhe të paaftë vetëm se ishin unionistë. Xhonturqit filluan të zbatonin ligje që shqiptarët nuk ishin mësuar deri atëherë, duke thënë se baza e konstitucionalizmit është barazia, pa marrë parasysh karakteristikat lokale.<sup>87</sup>

<sup>84</sup> Enver Ziya Karal, *Osmanlı Tarihi: İkinci Meşrutiyet ve Birinci Dünya Savaşı (1908-1918)*, Cilt. IX, Türk Tarih Kurumu Basımevi (Ankara: 2011), 245.

<sup>85</sup> Kristaq Prifti, *Dervish Hima (1872-1928)* (Tiranë: 8 Nëntori, 1987), 151.

<sup>86</sup> S. J. Shaw, E. K. Shaw, *Osmanlı İmparatorluğu Ve Modern Türkiye*, 346.

<sup>87</sup> Müfid Şemsi, *Şemsi Paşa, Arnavudluk ve İttihad-Terakki* (İstanbul: Nehir Yayınları, 1995), 19-20. Ndryshimet kushtetuese të vitit 1909 transferuan autoritetin nga sulltani te legjislatura dhe qeveria. Shumica e shoqatave të krijuara kishin qëllime politike dhe politika ishte përhapur edhe në ushtri dhe në shkolla. Komiteti “Bashkim dhe Përparim” nuk mundi t'i kundërvihet kësaj lëvizjeje asociacionizmi në atmosferën e ditëve të para. Por, pas kundërrevolucionit të prillit të vitit 1909, ligji mbi shoqatat, i datës 3 gusht 1909, u miratua dhe kjo u bë baza e parë ligjore e personave juridikë të tipit shoqatë në Perandorinë Osmane. İlhan Akın, *Türk Devrimi Tarihi* (İstanbul: Beta Basım Yayınları, 1989), 78; Hüseyin Hatemi, “Tanzimat ve Meşrutiyet Dönemlerinde

Ligjet që shkaktuan më shumë ankesa për shqiptarët ishin ligji i shoqërive dhe i bandave.<sup>88</sup> Në ligjet e lartpërmendura theksohej se ai që do të mbante armë, do të dënohej me gjashtë muaj burg; dhjetë vjet burg për ata që merrnin pjesë në banda, dhe dënimi me vdekje i priste organizatorët ose udhëheqësit e çetave. Më poshtë në ligj thuhej se, edhe sikur vetëm një anëtar i familjes të merrte pjesë në çeta, dënimin do ta pësonte gjithë familja dhe pasuria do t’i konfiskohej.<sup>89</sup> Sipas zyrtarëve të qeverisë, qëllimi i çetave shqiptare ishte sigurimi i autonomisë së Shqipërisë.<sup>90</sup>

Përballë këtij zhvillimi intelektualët shqiptarë u ndien të detyruar të qartësonin pozicionin e klubeve të tyre për të parandaluar kërcënimin ndaj shoqërive dhe klubeve në fjalë, dhe në këtë drejtim morën vendim në Kongresin e dytë të Manastirit të mbledhur në prill të vitit 1910. Vendimi i Kongresit ishte që klubet shqiptare, të mos jenë të lidhura me asnjë parti politike. Në ligj ishte parashikuar që klubet në mbledhjet e tyre të diskutonin vetëm çështje letrare dhe jo çështje politike. Për të mos shkaktuar asnjë keqkuptim, Kongresi deklaroi se klubet shqiptare nuk mund të merreshin me çështje të tjera përveç gjuhës dhe letërsisë.<sup>91</sup>

Me fillimin e zbatimit të ligjit mbi shoqatat dhe klubet, klubi shqiptar “Bashkimi i Stambollit” në vitin 1910 ishte i detyruar që ta ndryshonte emrin e tij. Për këtë, klubi vendosi të përdorte fjalën “*tamim-i maarif*” (përhapjen e arsimit) në vend të fjalës “bashkim”.<sup>92</sup> Në të njëjtën kohë ishte raportuar se vendosja e titullit ishte miratuar nga klubi dhe madje ishte dhënë edhe një deklaratë.<sup>93</sup> Por të njëjtën gjë nuk e bëri klubi “Bashkimi i Selanikut”. Ai nuk e dorëzoi deklaratën e klubit në kohën e

---

Derneklerin Gelişimi”, *Tanzimat’tan Cumhuriyet’e Türkiye Ansiklopedisi*, C. I (İstanbul: İletişim Yayınları, 1985): 198-204; Sina Akşin, *Şariatçı Bir Ayaklanma 31 Mart Olayı* (İstanbul: İmge Kitabevi Yayınları, 1994), 288.

<sup>88</sup> Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, 88.

<sup>89</sup> *İsmail Kemal Bey Hatıratı*, Ed: S.Story, çev: A.İslamoğulları - R. Hoxha (İstanbul, Tarih Vakfı Yayınları yayınları, 2009), 234-235; Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar*, 358.

<sup>90</sup> BOA. *Bâbiâli Evrak Odası Evrakı (B.E.O) 295468*.

<sup>91</sup> Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar*, 363.

<sup>92</sup> BOA. *Dâhiliye Nezareti Muhaberât-ı Umumiye İdaresi Belgeleri* (DH.MUİ), 57/40.

<sup>93</sup> BOA. *Dâhiliye Nezareti Muhaberât-ı Umumiye İdaresi Belgeleri* (DH.MUİ), 28-2 /16.

duhur. Për këtë arsye, Komiteti “Bashkim dhe Përparim” mori masa dhe kërkoi mbylljen e këtij klubi në përputhje me ligjin e shoqatave.<sup>94</sup>

Xhonturqit donin të krijonin një shtet të fortë centralist. Centralizimi në sytë e tyre ishte identike me panturqizmin. Këto tentativa në Shqipëri hasën në rezistencë të fortë.<sup>95</sup> Intelektualët shqiptarë, që synonin realizimin e zhvillimit politik, kulturor dhe ekonomik të kombit shqiptar dhe përgatitjen e pavarësisë me një qeveri kushtetuese, duke qenë të vetëdijshëm se një politikë centraliste do të kufizonte mundësitë që ofronte rendi kushtetues, e kundërshtuan këtë politikë të administratës së Turqve të Rinj. Politika centraliste e administratës për të siguruar unitetin e Perandorisë Osmane binte ndesh edhe me kërkesat e intelektualëve shqiptarë për një Shqipëri autonome. Shqiptarët nuk mund të pajtoheshin me regjimin e ri dhe në deklaratat që shpërndanin ishin kundër Komitetit “Bashkim dhe Përparim” dhe qeverisë kushtetuese.<sup>96</sup> Qëndrimi i ashpër i Komitetit “Bashkim dhe Përparim” ndaj shqiptarëve e ktheu bashkëpunimin e krijuar ndërmjet shqiptarëve dhe xhonturqve në një marrëdhënie konfrontuese dhe ndezi më tej revoltat nacionaliste shqiptare.

Kur xhonturqit u bindën se nuk mund ta përballonin vrullin e patriotizmit shqiptar me mjete legale, me intriga e me korrupsion, ata vendosën ta thyejnë atë me forcën e armëve.<sup>97</sup> Me shpalljen e gjendjes ushtarake në Shqipëri, mijëra shqiptarë të pafajshëm u vranë me ekzekutime, burgime dhe tortura.<sup>98</sup> Në disa fshatra të sanxhakut të Prizrenit ishin gjetur armë të ndryshme, municione dhe materiale të tjera.<sup>99</sup> Informacioni i detajuar mbi këtë temë jepet në një procesverbal të Portës së Lartë. Sipas këtij procesverbali, janë gjetur 1 770 armë dhe 11900 fishekë teke dhe 522 armë të ndryshme; 2 600 fishekë nga rrethi i lartpërmendur dhe disa fshatra të tjera dhe në Mitrovicë janë konfiskuar 124 pushkë. Po ashtu, në Prishtinë dhe Vushtrri nëntë persona që ishin

<sup>94</sup> BOA. *Dâhiliye Nezareti Muhaberât-ı Umumiye İdaresi Belgeleri* (DH.MUI), 33-2 /17.

<sup>95</sup> Rizaj, “Roli i shqiptarëve në Revolucionin”, 178.

<sup>96</sup> BOA. *Hariciye Nezareti Siyasî Kısmı Belgeleri* (HR.SYS), 119/14 (22. 10. 1909).

<sup>97</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime Politike në Shqipëri (1897-1942)*, përgatitja për botim dhe ilustrimi fotografik Marenglen Verli (Tiranë: Vllamasi, 2012), 50.

<sup>98</sup> BOA. *Hariciye Nezareti Siyasî Kısmı Belgeleri* (HR.SYS), 119/39 (6 korrik 1912).

<sup>99</sup> BOA. *Hariciye Nezâreti Sefaret Belgeleri* (HR.SFR-3), 622/39.

udhëheqës të kryengritjes ishin arrestuar nga autoritetet osmane.<sup>100</sup> Sipas studiuesve, kryengritjet shqiptare nuk ishin gjë tjetër veçse një reagim ndaj gabimeve të administratës së Komitetit “Bashkim dhe Përparim”.<sup>101</sup>

Kundërshtimi i centralizimit të shqiptarët bëhej gjithnjë e më luftarak. Në fillim të prillit të vitit 1909, kur filloi një kryengritje në sanxhakun e Pejës, Stambolli u detyrua të shpallte gjendjen ushtarake. Popullsia vendëse jo vetëm mbështeti kërkesën për gjuhën shqipe, por edhe kundërshtoi të ashtuquajturën taksë “oktruva” për mallrat që hynin në qytetet shqiptare. Si rezultat i bisedimeve, përplasjet u ndërpre në një kohë. Ismail Qemal Vlora, deputeti shqiptar i Vlorës dhe zëdhënësi i lëvizjes për autonomi shqiptare, mbrojti kryengritësit dhe kauzën e tyre në Parlamentin Osman, duke argumentuar se ata nuk ishin reaksionarë. Megjithatë, ai deklaroi se populli nuk e ka parë pozitivisht konstitucionalizmin sepse regjimi i ri nuk i ka dhënë asnjë përfitim krahinës.<sup>102</sup> Më 26 prill, një delegacion deputetësh shqiptarë vizituan Vezirin e Madh dhe i kërkuan qeverisë të dërgonte një delegacion në rajon për t’iu dhënë fund luftimeve. Por Veziri i Madh, Qamil Pasha e refuzoi ofertën, me pretendimin se një lëvizje e tillë do të shihej si shenjë dobësie. Nga fundi i prillit të vitit 1909, ajo që dukej si një konflikt i thjeshtë ishte kthyer në një kryengritje të plotë.<sup>103</sup>

Në momentin që drejtuesit e Komitetit “Bashkim dhe Përparim” u përpoqën të rivendosnin autoritetin qendror, ata u ndeshën me revolta dhe pakënaqësi të përgjithshme, të mbështetur pjesërisht nga disa prej Fuqive të Mëdha.<sup>104</sup> Kushtetuta, u pa si një kërcënim për privilegjet e shqiptarëve. Gjithashtu, fillimi i zbatimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak i shqetësoi shqiptarët. Në qershor të vitit 1909 shpërtheu një kryengritje sapo guvernatori njoftoi se do të mbahej një regjistër i pronave si bazë për taksimin. Qeveria e Stambollit iu drejtua një politike represioni. Kryengritësit u bashkuan kundër regjimit të Turqve të Rinj, i cili mendohej se do të shkatërronte “të drejtat dhe traditat e tyre të

<sup>100</sup> BOA. HR.SFR-3, 622/39.

<sup>101</sup> Suat Zeyrek, *Meşrutiyet: Osmanlı'da Birlikte Yaşamak Ya da Birlikte Dağılmak (I. Dünya Savaşına Kadar)* (İstanbul: Kitabevi, 2013), 106. Këtë e ka pohuar edhe Gazi Ahmet Muhtar Pasha që në vitin 1912.

<sup>102</sup> Ahmad, *Jön Türkler ve Osmanlı Milletler*, 78.

<sup>103</sup> *Po aty*.

<sup>104</sup> *Po aty*, 77.

lashta”.<sup>105</sup> Shqiptarëve nuk u pëlqente centralizimi dhe modernizimi i administratës. Sepse kjo kërkonte që ata të paguanin taksa dhe të futeshin në ushtri, si të gjithë osmanët, dhe të dorëzonin armët.<sup>106</sup>

Mes viteve 1909 dhe 1910, pakënaqësia e popullit shqiptar kundër politikave xhonturke po shtoej.<sup>107</sup> Më 30 prill 1910, gjenerali dhe politikani i njohur turk, Musa Kâzım Karabekir\*, në ditar kishte shkruar, “konflikt i dhunshëm sot”.<sup>108</sup> Fjala ishte për fillimin e kryengritjes në Kosovë më 1910 dhe luftimet në mes të kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë osmane.<sup>109</sup> Shtetarët osmanë që merreshin me punët e Shqipërisë, u ndanë më dysh në lidhje me këtë kryengritje. Disa prej tyre sugjeruan që të shmangej zbatimi i një politike terrori dhe të parandalohet rebelimi me masa më të arsyeshme. Një pjesë tjetër, me në krye ministrin e Luftës Mahmut Shefqet Pasha, dukej se ishin në favor të nxitjes së politikës së dhunës deri në shkallën e fundit.<sup>110</sup>

Mahmut Shefqet Pasha shpresonte se rebelimi në Shqipëri, do të shtypej përmes ndjekjes së një politikë terrori. Të të njëjtit mendim ishin edhe zyrtarë të tjerë shtetërorë. Në një kohë kur ishte e nevojshme të merreshin masa më të arsyeshme në përputhje me kërkesat e kryengritësve shqiptarë, autoritetet osmane vazhdonin me politikën e terrorit duke shpresuar se në këtë mënyrë do të ndalnin hovin e kryengritjeve shqiptare.<sup>111</sup>

Territoret ku jetonin shqiptarët ishin të hapura ndaj çdo lloj provokimi nga fuqitë e huaja, e veçanërisht për eksportimin e armëve dhe

<sup>105</sup> *Po aty*.

<sup>106</sup> Feroz Ahmad, *Bir Kimlik Peşinde Türkiye*, çeviren: Sedat Cem Karadeli (İstanbul: Bilgi Üniversitesi Yayınları, 2010), 69.

<sup>107</sup> Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (Studime dhe dokumente)* (Tiranë: UET Press, 2009), 417.

\* Për jetën dhe veprën e Musa Kâzım Karabekirit shih: Kâzım Karabekir, *Hayatım* (İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2018); Kâzım Karabekir, *İttihat ve Terakki Cemiyeti* (İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2017); Feridun Kandemir, *Kâzım Karabekir* (İstanbul: 1948); Cevdet Küçük, “Kâzım Karabekir”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi* (Ankara:TDV yayınları 2022), 25: 150-152.

<sup>108</sup> Kazım Karabekir, *Günlükler* (1906-1948), C.I (İstanbul: Yapı Kredi yayınları, 2009), 135.

<sup>109</sup> BOA. *Dâhiliye Nezareti Muhaberât-ı Umumiye İdaresi Belgeleri* (DH. MUI), 80/3/10.

<sup>110</sup> Ziya Şakir, *Mahmut Şevket Paşa* (İstanbul: Akıl Fikir Yayınları, 2011), 106-107.

<sup>111</sup> *Po aty*, 106.

vullnetarëve nga Italia.<sup>112</sup> Pavarësisht kësaj, politikat e gabuara të Turqve të Rinj ndaj shqiptarëve vazhdonin. Fillimisht, me konfiskimin e armëve nga duart e shqiptarëve, administrata xhonturke eliminoi një forcë të madhe për vetë mbrojtjen e Perandorisë.<sup>113</sup>

Ministri i Brendshëm, Talat Pasha kërkonte që kryengritja e Kosovës të qetësohej sa më parë, por ai nuk mund të kuptonte se çfarë masash duheshin zbatuar. Ndërsa anëtari i përhershëm i Komitetit Qendror dhe sekretari i Përgjithshëm i Komitetit “Bashkim dhe Përparim”, doktor Nazim Beu, u shpreh se një lëvizje e madhe gjithëpërfshirëse duhej bërë në të gjithë Shqipërinë. Sipas Nazim Beut, armët në duart e shqiptarëve duhej të tërhiqeshin plotësisht.<sup>114</sup>

Talat Pasha nuk u pajtua përkohësisht me këtë ide ekstremiste të doktor Nazim Beut. Ministri i Brendshëm shprehu shqetësimin e tij për situatën në këtë mënyrë: “Kam frikë. Ne do t’i bëjmë vetes një telash të madh”. Kishte edhe nga ata që kundërshtuan idenë e qortimit dhe reformës së ashpër të paraqitur nga doktor Nazim Beu. Për shembull, një nga anëtarët dhe nëpunësit e rëndësishëm të Komitetit “Bashkim dhe Përparim”, doktor Bahaeddin Shakir Beu ishte krejtësisht kundër kësaj ideje. Ai u shpreh se:

“shqiptarët janë mburojë kundër Austrisë dhe Italisë. Për mendimin tim; Aty duhet të ketë forca të mjaftueshme ushtarake. Shqiptarët duhet të nënshtrohen. Kudo duhet bërë një milici prej tyre. Në këtë mënyrë duhet pasur kujdes për shfrytëzimin e shqiptarëve për interesat e perandorisë”.<sup>115</sup>

Deputetët shqiptarë deklarorin se përdorimi i dhunës pa hetuar ngjarjet do ta shkatërronte Shqipërinë, e cila ishte çelësi i Rumelisë. Turqit e Rinj, nga ana tjetër, nuk i morën parasysh këto deklarata dhe zgjodhën rrugën e ndëshkimit. Për këtë ndërmorën një aksion ushtarak.<sup>116</sup> Më 8 maj 1910, Mahmut Shefqet Pasha duke thënë: “Unë i njoh mirë shqiptarët. Kjo punë nuk mbaron pa rrahje” erdhi në Shqipëri dhe filloi konfiskimin e armëve nga duart e popullit.<sup>117</sup> Veprimet ushtarake kundër

<sup>112</sup> BOA. *Sadâret Mektubî Kalemi Mühimme Kalemi Belgeleri* (A. MKT. MHM), 736/09.

<sup>113</sup> BOA. *Meclis-i Vükela Mazbataları* (MV), 152/77 (23 Mayıs 1911).

<sup>114</sup> Şakir, *İttihat ve Terakki*, 581.

<sup>115</sup> *Po aty*, 582.

<sup>116</sup> Zeyrek, *Meşrutiyet: Osmanlı'da Birlikte Yaşamak Ya da Birlikte Dağılmak*, 106.

<sup>117</sup> *Po aty*.

shqiptarëve shtuan urrejtjen e popullit kundër administratës osmane dhe forcuan pushtetin e nacionalistëve shqiptarë.<sup>118</sup>

Kur u mbledh në Selanik në tetor të vitit 1910 kongresi vjetor i Komitetit “Bashkim dhe Përparim”, mungesa e delegatëve shqiptarë zgjoi dyshime. Ky ishte një pasqyrim i trazirave të vazhdueshme. Gazeta “The Times” e datës 25 prill 1911 raportonte se Austro-Hungarisë i ishte bërë thirrje për të ndërhyrë në Shqipëri. Gazetat katolike si “Vaterland” dhe “Reichspost” në Austro-Hungari bënë thirrje për një ndërhyrje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë austro-hungareze në rajon për të mbështetur kryengritjen katolike në Malësi. Në fillim, Porta e Lartë luftonte me shqiptarët myslimanë, por sidomos kur komandanti i korpusit, Shefqet Turgut Pasha, kërcënoi se do të digjte fshatrat katolike nëse banorët e tyre nuk dorëzoheshin, elementi fetar hyri në lojë bashkë me kërcënimin e ndërhyrjes së huaj.<sup>119</sup>

Shefqet Turgut Pasha nuk dogji fshatrat katolike, nuk pati ndërhyrje të huaja dhe lufta në mes shqiptarëve e forcave osmane vazhdoi. Por administrata osmane këtu dështoi shumë seriozisht. Ndërsa pozicioni politik i unionistëve u dobësua, opozita liberale u forcua më shumë. Si rezultat, Porta e Lartë u tërhoq dhe bëri lëshime të rëndësishme, duke lejuar përdorimin e alfabetit latin në Shqipëri, ndërkohë që ligji ushtarak u hoq.<sup>120</sup>

Për të qetësuar rajonin, Sulltan Mehmet Reshati bëri një vizitë në Kosovë dhe ujërat u qetësuan pak. Pas vizitës së sulltanit në Kosovë, Porta e Lartë u detyrua të hynte në bisedime me krerët shqiptarë dhe të bënte disa lëshime kundrejt kërkesave të shqiptarëve. Por trazirat në Shqipëri vazhduan duke çuar në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912. Ashtu si në vitin 1908, edhe në zgjedhjet e vitit 1912 kishte mashtime. Për këtë arsye në shumë vende pati kundërshtime për rezultatet e zgjedhjeve.<sup>121</sup> Xhelal Nuri e ka vlerësuar procesin e zgjedhjeve si gabimin më të madh të Komitetit “Bashkim dhe Përparim” dhe ka theksuar se në këtë proces janë goditur partitë shqiptare dhe arabe.<sup>122</sup>

<sup>118</sup> *Po aty*, 105.

<sup>119</sup> Ahmad, *Jön Türklər ve Osmanlı Milletler*, 79.

<sup>120</sup> *Po aty*.

<sup>121</sup> Suat Zeyrek, “II. Meşrutiyet’te Demokratik Muhalefetin Sonu: Arnavut İsyanları ve Sonuçları”, *Erciyes Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi*, 33 (2012): 305.

<sup>122</sup> Celal Nuri, *Tarih-i İstikbal, Mesail-i Siyasiye 2* (İstanbul: Yeni Osmanlı Matbaası, 1331), 70.



Gjatë verës së vitit 1912, kryengritja shqiptare kishte marrë përmasa të mëdha. Më në fund, nën presionin e Komitetit Qendror, ministri i Luftës, Mahmut Shefqet Pasha, u shkarkua nga posti i ministrit. Në maj dhe qershor të vitit 1912, disa oficerë në Stamboll kishin krijuar një grup të quajtur “Grupi i oficerëve shpëtimtarë” (Halâskâr Zâbitân Grubu). Ky grup kishte marrëdhënie me njësitë rebele në Maqedoni dhe me Partinë e Lirisë dhe Marrëveshjes në Stamboll. Synimi i tyre ishte të merrnin pushtetin nga Komiteti “Bashkim dhe Përparim” dhe të rivendosnin “qeverinë ligjore”. Ata, gjithashtu, donin që forcat e armatosura të tërhiqeshin nga politika dhe t’ua linin qeverinë politikanëve dhe nëpunësve civilë.<sup>123</sup>

“Grupi i oficerëve shpëtimtarë” shkaktoi konflikte brenda Komitetit “Bashkim dhe Përparim”. Mosmarrëveshja e Mahmut Shefqet Pashës me kabinetin për çështjen se ngjarjet në rajonin shqiptar nuk mund të zgjidheshin me mjete ushtarake, detyruan ministrin e Luftës të jepte dorëheqjen nga posti i tij. Veziri i Madh, Said Pasha nuk hezitoi të kritikonte ashpër ministrin e Luftës në takimet e tij për këtë temë. Prandaj, me dorëheqjen e pashait, unionistët jo vetëm që do të kishin penguar kritikën e opozitës, por edhe do të kishin hequr qafe dikë që kishte frikë nga pushteti i tij dhe të cilin kishin filluar ta shihnin si pengesë.<sup>124</sup> Pra, dorëheqja e pashait kërkohet nga unionistët.<sup>125</sup> Në lidhje me këtë çështje politikani i njohur turk, Celal Bayar (Xhelal Bajar), shprehej se ministri i Luftës nuk mundi të merrte masat e duhura dhe në kohë kundër organizatave politike në ushtri dhe si rezultat, atij iu kërkua të jepte dorëheqjen. Gjithashtu, Bayar-i thekson se pashai kishte pasur një mosmarrëveshje me figurat e shquara të Komitetit “Bashkim dhe Përparim” për ngjarjet në Shqipëri. Dështimi në Tripoli dhe qëndrimi i tij i dobët ndaj kryengritjes shqiptare ndikoi edhe në karrierën politike të pashait.<sup>126</sup> Dorëheqja e ministrit të Luftës, në vend që të sillte zgjidhje të situatës, i ngatërroi edhe më shumë gjërat. Një post jetik i qeverisë mbeti

<sup>123</sup> Ahmad, *İttihat ve Terakki*, 154.

<sup>124</sup> *Osmanlı Mebûsân Meclisi Reisi Halil Menteşe'nin Anıları* (İstanbul: Hürriyet, 1986), 147-148.

<sup>125</sup> *Şeyhülislam Ürgüplü Mustafa Hayri Efendi'nin Meşrutiyet, Büyük Harp ve Mütareke Günlükleri (1909-1922)* (İstanbul: İş Bankası Kültür Yay., 2015), 122.

<sup>126</sup> Celal Bayar, *Ben de Yazdım: Milli Mücadeleye Gidiş*, C.II (Sabah Kitapları 1997), 124.

bosh gjatë një kohe depresioni.<sup>127</sup> Gjetja e një ministri të ri për t'u emëruar në vend të Mahmut Pashës u bë problem. Në trazirat e vazhdueshme, refuzimi i një personi të vetëm me ndjenjë përgjegjësie dhe arsye të shëndoshë për të pranuar postin e ministrit të Luftës çoi në diskreditimin e kabinetit, të cilin Komiteti “Bashkim dhe Përparim” po përpiqej ta shpëtonte me të gjitha forcat.<sup>128</sup> Por përpjekjet e Komitetit ishin të kota, pasi edhe grupi i oficerëve shpëtimtarë filloi të merrte masa. “Një manifest i botuar në shtyp, një deklaratë dërguar Sulltanit përmes Këshillit Ushtarak dhe mbi të gjitha disa përgatitje dhe veprimtari ushtarake të ndërmarra dhanë rezultate të qarta në një kohë të shkurtër”. Gjendja e Komitetit po përkeqësohej me shpejtësi. Pasi kishte humbur çdo shpresë, Veziri i Madh, Said Pasha dha dorëheqjen më 16 korrik 1912.<sup>129</sup> Feroz Ahmad është shprehur se në Komitetin “Bashkim dhe Përparim” nuk kishte dëshirë për të punuar më tej. Ai ishte në një gjendje gati për t'u rrëzuar. Në një fjalim të tij, Talati i tha Halil Beut:

“Miku im i dashur, ne po kalojmë një krizë, po përballemi me një të dytë. Vazhdimisht pyes veten, a po e shkatërrojmë vendin. Atëherë le ta marrin të tjerët. A nuk janë edhe ata bijtë e këtij vendi? Ndoshta ata mund të bëjnë më mirë se ne. Do të ndihmojmë edhe ne. A nuk është qëllimi t'i shërbejmë vendit?”<sup>130</sup>

Ndërsa Fevzi Çakmak, është shprehur se “‘Komiteti i Bashkimit dhe Përparimit’ vendosi të tërhiqet për të qetësuar rebelimin shqiptar”.<sup>131</sup>

Më 21 korrik 1912, Gazi Ahmet Muhtar Pasha u emërua Vezir i Madh në vend të Said Pashës. Praktikant e para të kabinetit të ri, i cili pretendonte se do të ishte neutral, kanë qenë marrja e masave në formën e koncesioneve për heqjen e gjendjes ushtarake dhe zgjidhjen e rebelimit në Shqipëri.<sup>132</sup>

Qasja e Gazi Ahmet Muhtar Pashës ndaj çështjes shqiptare dhe pikëpamjet e tij për këtë çështje ishin krejtësisht të ndryshme. Sipas

<sup>127</sup> Ahmad, *İttihat ve Terakki*, 155.

<sup>128</sup> *Po aty*.

<sup>129</sup> *Po aty*; shih dhe: Ali Fuad Türkogeldi, *Görüp İttiklerim*, Türk Tarih Kurumu (Ankara: 1951), 55; Rifat Uçarol, *Gazi Ahmet Muhtar Paşa 1839-1919 Askeri ve Siyasi Hayatı* (İstanbul: Derin Yayınları, 2015), 339.

<sup>130</sup> Ahmad, *İttihat ve Terakki*, 156.

<sup>131</sup> Nilüfer Hatemi, *Fevzi Çakmak ve Günlükleri*, C.I (İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2002), 169.

<sup>132</sup> Uçarol, *Gazi Ahmet Muhtar Paşa*, 337.

Ahmet Muhtar Pashës, kryengritja nuk ishte një akt kundër shtetit, por vetëm për shkak se një parti politike sulmoi lirinë e tyre (Komiteti “Bashkim dhe Përparim”). “Delegacioni shtetëror” nuk ishte i detyruar t’i sillte kryengritësit në bindjen e asaj partie. Përkundrazi, ai ishte i detyruar të mbronte liritë e tij. Populli kërkonte, gjithashtu, që kërkesat e kryengritësve të shqyrtoheshin nga një komision i drejtë dhe i paanshëm.<sup>133</sup> Ahmet Muhtar Pasha, i cili e shihte në këtë mënyrë natyrën e kryengritjes dhe e pa të gabuar politikën e ndjekur nga paraardhësi i tij, Said Pasha, sapo erdhi në pushtet e ndaloi aksionin ushtarak. Qeveria e re u dha menjëherë urdhër ushtrive osmane të ndërprinin luftimet në Shqipëri dhe njoftoi nisjen për në Prishtinë të një delegacioni zyrtar të kryesuar nga mareshali Ibrahim Pasha, me origjinë nga Manastiri, i cili shoqërohej nga dy personalitetet e tjera, gjithashtu shqiptare, Ali Danish Prishtina, diplomat nga Kosova dhe Sulejman Pashë Kolonja, ushtarak nga Kolonja.<sup>134</sup>

Më 27 korrik 1912, komisioni mbërriti në Shqipëri. Megjithatë, kërkesa e parë e fisnikëve shqiptarë përpara se të fillonin negociatat ishte shpërbërja e menjëhershme e Parlamentit.<sup>135</sup> Shqiptarët njoftuan se do të fillonin sulmet brenda 48 orëve, nëse nuk shpërndahej Parlamenti.<sup>136</sup> Në përgjigje të telegrameve, Veziri i Madh u kërkoi krerëve shqiptarë të bënin durim.<sup>137</sup>

Në bisedimet me delegacionin osman, intelektual i dhe ish-deputeti i Parlamentit Osman, Hasan Prishtina sulmoi ashpër regjimin e Komitetit “Bashkim dhe Përparim” dhe politikën e tyre të ndjekur gjatë katër vjetëve në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, Hasan Prishtina kërkoi shpërndarjen e menjëhershme të Parlamentit Osman.<sup>138</sup> Në këtë periudhë kishte probleme mes Parlamentit dhe qeverisë për shkak të ndryshimit të kushtetutës, prandaj Parlamenti u shpërnda më 5 gusht 1912.<sup>139</sup>

<sup>133</sup> Celal Bayar, *Bende Yazdım, Milli Mücadeleye Gidiş*, 3 (İstanbul: 1966), 781-782.

<sup>134</sup> Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, 68-69.

<sup>135</sup> BOA. *Hariciye Nezareti Siyasî Kısmı Belgeleri* (HR. SYS), 151/74.

<sup>136</sup> *Po aty*.

<sup>137</sup> Uçarol, *Gazi Ahmet Muhtar Paşa*, 341.

<sup>138</sup> BOA. *Hariciye Nezareti Siyasî Kısmı Belgeleri* (HR. SYS), 151/74.

<sup>139</sup> Me dështimin e qeverisë së re për të marrë një votëbesim nga Parlamenti, në të cilin unionistët kishin shumicën, sulltani shpërnda Parlamenti me kërkesë të Vezirit të Madh. Zuhuri Danişman, *Osmanlı İmparatorluğu Tarihi*, C. XIV (İstanbul: Zuhuri Danişman Yayınevi, 1966), 34.

Hasan Prishtina i paraqiti Portës së Lartë, më 9 gusht 1912, një memorandum, me të cilin nuk kërkohej haptas autonomia, por disa reforma, të cilat siç është shprehur profesor Kristo Frashëri, po të zbatoheshin, do t'i jepnin vendit *de facto* një autonomi administrative.<sup>140</sup> Ibrahim Pasha ia dërgoi këto kërkesa Portës së Lartë dhe premtoi se do të mbështeste krerët e kryengritjes shqiptare.<sup>141</sup> Në fund u pranuan nga Hasan Prishtina përgjigjet pozitive dhënë nga Porta e Lartë më 18 gusht, për miratimin e kërkesave të shqiptarëve, me përjashtim të kërkesës për dënimin e kabinetit të Haki dhe Said Pashës, si dhe kthimin e armëve. Kjo çoi në përfundimin e kryengritjes shqiptare. Mirëpo, duke qenë se në këtë kohë shtetet ballkanike kishin filluar të punonin intensivisht kundër Perandorisë Osmane, vëmendja e Portës së Lartë u përqendrua në këto pika dhe edhe problemi shqiptar kaloi në plan të dytë. Sipas historianit Tarik Zafer Tunaya-s (T. Z. Tunaja), kabineti i Gazi Ahmet Muhtar Pashës pranoi kushtet e revolucionarëve, shpalli amnisti të përgjithshme dhe hoqi ligjin ushtarak dhe u shpall zyrtarisht se problemi shqiptar ishte zgjidhur. Mirëpo, pikërisht në këtë kohë, shpërtheu Lufta Ballkanike dhe filloi një fazë e re në historinë e Shqipërisë.<sup>142</sup>

Politikat e fshehta të nacionalizmit dhe centralizmit të Komitetit “Bashkim dhe Përparim” kishin shkaktuar reagime serioze. Pa këto politika centralizimi, shqiptarët nuk do të ishin shfaqur si njerëz me ndjenja armiqësore në njëfarë kuptimi. Komiteti në të gjitha politikat e tij kishte një synim të rëndësishëm për të mbajtur nën kontroll opozitën.<sup>143</sup>

Politika turko-nacionaliste e “Bashkimit dhe Përparimit” ishte në kundërshtim me politikën osmane të Tanzimatit. Tashmë, edhe popujt myslimanë, arabët dhe shqiptarët donin të largoheshin nga Perandoria.<sup>144</sup> Si në Rumeli ashtu edhe në Anadoll, Turqit e Rinj ndoqën politikën e turqizimit dhe u përpoqën t’ua impononin gjuhën turke arabëve, shqiptarëve dhe myslimanëve të tjerë joturq.<sup>145</sup> Ahmet Bedevi Kuran ka

<sup>140</sup> Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, 72.

<sup>141</sup> Në lidhje me kërkesat e krerëve shqiptarë, shih gazetën: *Sabah*, 16 Ağustos 1912, 2; si dhe *Hikmet Gazetesi*, 23 Ağustos 1912, 1.

<sup>142</sup> Tarik Zafer Tunaya, *Türkiye’de Siyasal Partiler C. I. İkinci Meşrutiyet Dönemi* (İstanbul: İletişim, 2015), 538.

<sup>143</sup> Zeyrek, “II. Meşrutiyet’te Demokratik Muhalefetin Sonu”, 327.

<sup>144</sup> Halil İnalçık, *Türklük Müslümanlık ve Osmanlı Mirası* (İstanbul: Kırmızı Yayınları, 2017), 274.

<sup>145</sup> Bernard Lewis, *Modern Türkiye’nin Doğuşu*, çeviren: Babür Turna (Ankara: Arkadaş Yayınları, 2013), 297.

deklaruar se “*xhonturqit i shikonin ngjarjet e vendit dhe të botës vetëm në letër e në tavolinë, dhe nuk mendonin për vuajtjet e popullit dhe fatet e vendit, prandaj ata po binin nga gabimi në gabim.*”<sup>146</sup> Kjo është një deklaratë e qartë e bërë nga një bashkëkohës i ngjarjeve për të treguar pjesën e dështimit të Turqve të Rinj në problemet e përjetuara në Shqipëri. Mary Edith Durham ka përdorur shprehje të ngjashme në veprat e saj, se xhonturqit kanë ndjekur politikën e gabuar në lidhje me Shqipërinë.<sup>147</sup>

Ndërsa në një deklaratë të bërë nga deputetët shqiptarë thuhej se, publiku osman nuk duhet të dyshojë se flamuri i revolucionit të shqiptarëve nuk kishte për qëllim vetëm marrjen në dorë të fatit të Shqipërisë, por edhe për të shpëtuar osmanët nga gjendja e keqe në të cilën kishin rënë.<sup>148</sup> Sipas një dokumenti osman të datës 6 gusht 1912, udhëheqësit e kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912 në një takim që kishin pasur me zëvendëskonsullin grek në Berat, kishin deklaruar se arsyeja e kësaj kryengritjeje ishte vetëm në emër të atdheut “Osman” dhe “Shqipërisë”, dhe se nuk do të punonin asnjëherë për aspiratat e Greqisë. Si pasojë e kësaj kishte lindur një mosmarrëveshje në mes të udhëheqësve shqiptarë dhe zëvendëskonsullit grek.<sup>149</sup> Një oficer turk në një punim të shkruar në fillim të shek. XX, është shprehur:

“Para së gjithash, çdo osman duhet ta dijë mirë se po të mos kishte qenë Shqipëria myslimane, Turqia do t'i kishte thënë lamtumirë Rumelisë saktësisht njëqind e pesëdhjetë vjet më parë. Shqiptarët janë një komb patriot, fisnik dhe trim. Arsyeja e vetme e fatkeqësisë që po pësojnë shqiptarët sot është politika e gabuar dhe e keqe e Bashkimit dhe Përparimit për katër vjet. Kjo politikë famëkeqe shkaktoi fatkeqësi jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të gjithë osmanëve”.<sup>150</sup>

<sup>146</sup> Ahmet Bedevi Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*, 2. Basım (İstanbul: Kaynak Yayınları, 2000), 367.

<sup>147</sup> Mary Edith Durham, *20 Vjet Ngaterresa Ballkanike*, përktheu Selaudin Toto (Tiranë: Argeta LMG, 2019).

<sup>148</sup> Hüseyin Kazım Kadri, *Türkiye'nin Çöküşü: II. Meşrutiyet'in Perde Arkası, Makedonya, Arnavutluk, Suriye ve Ermenistan'ın Elden Çıkışı*, Yayına Hazırlayan: Yılmaz Daşcıoğlu (İstanbul: Hikmet Neşriyat, 1992), 109.

<sup>149</sup> BOA. *Hariciye Nezareti Siyasî Kısmı Belgeleri* (HR.SYS), 119/41 (6 gusht 1912).

<sup>150</sup> Ahmed Hamdi, *Arnavudluk Hakkında Mutalaa-yı Muhtasara (Arnavutluk Hükümeti Nasıl Olmalıdır?)* (İstanbul: 1920).

**Bibliografi:****Arkiva:**

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondi 19/ Dr. Ibrahim Temo

B. Türkiye Cumhuriyeti Cumhurbaşkanlığı Devlet Arşivi Başkanlığı Osmanlı Arşivi (BOA)

**Literaturë historiografike:**

Ahmed, Hamdi. *Arnavudluk Hakkında Mutalaa-yı Muhtasara (Arnavutluk Hükümeti Nasıl Olmalıdır?)*. İstanbul: 1920.

Ahmeti, Nuridin. *Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*. Instituti Albanologjik. Prishtinë: 2017.

Ahmad, Feroz. *Bir Kimlik Peşinde Türkiye*. Çeviren: Sedat Cem Karadeli İstanbul: Bilgi Üniversitesi Yayınları, 2010.

Ahmad, Feroz. *İttihat ve Terakki 1908-1914*. çeviren: Nuran Yavuz. İstanbul: Kaynak Yayınları, 2016.

Ahmad, Feroz. *Jön Türkler ve Osmanlı Milletler; Ermeniler, Rumlar, Arnavutlar, Yahudiler ve Araplar*. Çeviren: Ayşen Gür. İstanbul Bilgi Üniversitesi Yayınları. İstanbul: 2017.

Akın, İlhan. *Türk Devrimi Tarihi*. İstanbul: Beta Basım Yayınları, 1989.

Akşin, Sina. *Şeriatçı Bir Ayaklanma 31 Mart Olayı*. İstanbul: İmge Kitabevi, 1994.

Akşin, Sina. *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*. Ankara: İmge Kitabevi, 2014.

Alkend, Nureddin Ferruh. *Ahrar Fırkası ve 2. Meşrutiyet Anıları*. Hazırlayan: Ali İhsan Kolcu. İstanbul: Babil, 2017.

Şemsi, Müfit. *Şemsi Paşa, Arnavudluk ve İttihat-Terakki*. İstanbul: Nehir Yayınları 1995.

Birecikli, İhsan Burak. *Arnavutlar ve Arnavutluk Sorunu 1908-1914*. Gazi Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü. Tezë doktora. Ankara: 2010.

Bayar, Celal. *Bende Yazdım, Milli Mücadeleye Gidiş*. 3 İstanbul: 1966.

Bayar, Celal. *Ben de Yazdım: Milli Mücadeleye Gidiş, C.II*. İstanbul: Sabah Kitapları, 1997.

Bartl, Peter. *Myslیمانët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*. Përktheu: Nestor Nepravishta. Tiranë: Dituria, 2006.

Bartl, Peter. *Millî Bağımsızlık Hareketleri Esnasında Arnavutluk Müslümanları 1878-1912*. Çeviren: Ali Taner. İstanbul: Bedir Yayını, 1998.

Berkes, Niyazi. *Türkiye'de Çağdaşlaşma*. Yayına Hazırlayan Ahmet Kuyaş. İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2002.

- Celal Nuri. *Tarih-i İstikbal, Mesail-i Siyasiye 2*. İstanbul: Yeni Osmanlı Matbaası, 1331.
- Çabuk, Vahid. *Sultan II. Abdülhamid*. İstanbul: Paraf Yayınları, 2010.
- Çavdar, Tevfik. *İttihat ve Terakki*. İstanbul: İletişim Yayınları, 1991.
- Çelik, Bilgin. *İttihatçılar ve Arnavutlar*. İstanbul: Büke Kitapları, 2004.
- Demir, Fevzi. *Osmanlı Devleti'nde II. Meşrutiyet Dönemi Meclis-i Mebusan Seçimleri 1908-1914*. Ankara: 2007.
- Duka, Ferit. *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (Studime dhe dokumente)*. Tiranë: UET Press, 2009.
- Durham, Mary Edith. *20 Vjet Ngaterresa Ballkanike*. Përktheu Selaudin Toto. Tiranë: Argeta LMG, 2019.
- Danişman, Zuhuri. *Osmanlı İmparatorluğu Tarihi*. C. XIV, İstanbul: Zuhuri Danişman Yayınevi, 1966.
- Eraslan, Cezmi. “Osmanlı Devletinin Arnavutlara Yönelik Politikalarında Birinci ve İkinci Meşrutiyet Dönemlerinin Karşılaştırılması”. *Güneydoğu Avrupa Araştırmaları Dergisi*, Sayı: 13, 2014.
- Engin, Vahdettin. *Bir Devrin Son Sultan II. Abdülhamid*. İstanbul: Yeditepe yayınevi, 2017.
- Frashëri, Kristo. *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912)*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë: 2008.
- Fshazi, Falma. “2. Meşrutiyet ve Arnavutluk'taki Osmanlı Algısı: Arnavutlarla Osmanlı'nın Düşman Olduğu O An”. *İstanbul Üniversitesi Siyasal Bilgiler Fakültesi Dergisi*, Sayı: 38, 2008.
- Gawrych, George W. *Hilal ve Kartal; Osmanlı Yönetimi, İslam ve Arnavutlar 1874-1913*. Çeviren, Ali Fahri Doğan. İstanbul: Selenge Yayınları, 2021.
- Georgeon, François. *Sultan Abdülhamid*. Çevirmen: Ali Berktaş. İstanbul: Homer Yayınları, 2006.
- Hatemi, Hüseyin. “Tanzimat ve Meşrutiyet Dönemlerinde Derneklerin Gelişimi”. *Tanzimat'tan Cumhuriyet'e Türkiye Ansiklopedisi*, C. I. İstanbul: İletişim Yayınları, 1985.
- İsmail Kemal Bey *Hatıratı*. Ed: S.Story, çev: A.İslamoğulları - R. Hoxha. İstanbul, Tarih Vakfı Yayınları yayınları, 2009.
- Özdemir, Hakan. *Abdülhamid'i Deviren Kurşun*. İstanbul: Timaş Yayınları, 2014.
- Ünlü, Talha Burak. *İttihatçı Bir Fedai: Mülazım Atıf Kamçıl*. İstanbul: Timaş Yayınları, 2021.
- Prifti, Kristaq. “Kontributi i shqiptarëve në Lëvizjen e Turqve të Rinj (1889-1908)”. *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike 31-32, 2001-2002. Prishtinë: 2003.

- Kaleshi, Hasan. "Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll". *Gjurmime Albanologjike*, 1. Prishtinë: 1969.
- Hatemi, Nilüfer. *Fevzi Çakmak ve Günlükleri*. C.I İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2002.
- Hanioğlu, M. Şükrü. "Jön Türkler". *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. İstanbul: TDV yayınları 2001, 23.
- Hanioğlu, Mehmet Şükrü. *Bir Siyasal Örgüt Olarak Osmanlı İttihat ve Terakki Cemiyeti ve Jön Türklük (1889-1902)*. İstanbul: İletişim Yayınları, 1985.
- Hanioğlu, M. Şükrü. *Bir Siyasal Örgüt Olarak İttihat ve Terakki Cemiyeti ve Jön Türklük (1889-1902)*. C.I. İstanbul: İletişim Yayınları, 1989.
- Hanioğlu, M. Şükrü. "Meşrutiyet". *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. Ankara: TDV yayınları, 2004), 29.
- Hanioğlu, M. Şükrü. "İbrahim Temo (1865-1945) İttihat ve Terakki Cemiyeti kurucularından Osmanlı siyaset adamı". *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*. İstanbul: TDV Yayınları, 2000), 21.
- İnalçık, Halil. *Türklük Müslümanlık ve Osmanlı Mirası*. İstanbul: Kırmızı Yayınları, 2017.
- Smakaj, Gentrit. *İttihat ve Terakki ve Arnavut Meselesi (1908-1913)*. Akdeniz Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü. Tezë doktrature. Antalya: 2022.
- Smakaj, Gentrit. "Shtypi shqiptar në epokën e dytë kushtetuese dhe qëndrimi i Portës së Lartë ndaj tij". *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike, 52. Prishtinë: 2022.
- Smakaj, Gentrit. "Kontributi i një shqiptari nga Ohri në revolucionin xhonturk". *Revista Shenja*, maj 2020.
- Mantran, Robert. *Historia e Perandorisë Osmane*. përktheu Asti Papa. Tiranë: Dituria, 2004.
- Maden, Fahri. "Arnavutluk'un Bağımsızlık Süreci (1878-1913)". *Avrasya Etütleri*, 38, 2011.
- Kadri, Hüseyin Kazım. *Türkiye'nin Çöküşü: II. Meşrutiyet'in Perde Arkası, Makedonya, Arnavutluk, Suriye ve Ermenistan'ın Elden Çıkışı*. Yayına Hazırlayan: Yılmaz Daşcıoğlu. İstanbul: Hikmet Neşriyat, 1992.
- Kansu, Aykut. *1908 Devrimi*. Çeviri: Ayda Erbal. İstanbul: İletişim, 2001.
- Karal, Enver Ziya. *Osmanlı Tarihi: İkinci Meşrutiyet ve Birinci Dünya Savaşı (1908-1918)*. Cilt. IX. Ankara: Türk Tarih Kurumu, 2011.
- Kayalı, Hasan. *Jön Türkler ve Araplar. Osmanlıcılık, Erken Arap Milliyetçiliği ve İslamcılık 1908-1918*. Çeviren: Türkan Yöney. İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2019.



- McCarthy, Justin. *Osmanlı'ya Veda / İmparatorluk Çökerken Osmanlı Halkları*. Çeviren Mehmet Tuncel. İstanbul: Nesil Yayınları, 2006.
- Karabekir, Kazım. *Günlükler (1906-1948)*. C.I. İstanbul: Yapı Kredi yayınları, 2009.
- Karabekir, Kâzım. *Hayatım*. İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2018.
- Karabekir, Kâzım. *İttihat ve Terakki Cemiyeti*. İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2017.
- Kandemir, Feridun. *Kâzım Karabekir*. İstanbul: 1948.
- Kili Suna, Gözübüyük & A. Şeref. *Türk Anayasa Metinleri (Sened-i İttifaktan Günümüze)*. İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları, 2000.
- Küçük, Cevdet. “Kâzım Karabekir”. *Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi*, 25. Ankara:TDV yayınları 2022.
- Kuran, Ahmet Bedevi. *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*. İstanbul: Kaynak Yayınları, 2000.
- Kaan, Oğuz. *Osmanlı Ahrar Fırkası*. Ankara: Gazi Kitabevi, 2021.
- Koloğlu, Orhan. *Abdülhamit Gerçeği*. İstanbul: Pozitif Yayınevi, 2021.
- Külçe, Süleyman. *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk*. İzmir: Genelkurmay Basımevi, 1944.
- Kulçe, Süleyman. *Firzofik Toplantısı ve Meşrutiyet*. İstanbul: Kitabevi, 2013.
- Lewis, Bernard. *Modern Türkiye'nin Doğuşu*. Çeviren: Babür Turna. Ankara: Arkadaş Yayınları, 2013.
- Lewis, Bernard. *Modern Türkiye'nin Doğuşu*. Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1991.
- Lewis, Bernard. *Lindja e Turqisë moderne*. Përktheu Krenar Hajdëri. Tiranë: IDK, 2012.
- Mezani, Rezart. *İttihat ve Terakki, Arnavutlar ve Arnavutluk*. Ege Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü. Tezë Masteri. İzmir: 2003.
- Mardin, Şerif. *Yeni Osmanlı Düşüncesinin Doğuşu*. İstanbul: İletişim Yayınları, 2017.
- Osmanlı Mebûsân Meclisi Reisi Halil Menteşe'nin Anıları*. İstanbul: Hürriyet, 1986.
- Öztuna, Yılmaz. *II. Abdülhamid Zamanı ve Şahsiyeti*. İstanbul: Ötüken Neşriyat, 2017.
- Olgun, Kenan. *1908-1912 Osmanlı Meclis-i Mebusanı'nın Faaliyetleri ve Demokrasi Tarihimizdeki Yeri*. Ankara: 2014.
- Ortaylı, İlber ve Şadi & Erol Erdinç. *İttihat ve Terakki; Osmanlı İmparatorluğu'nda Gizli Örgütlenmeler ve Darbeler*. Hazırlayan: Alper Çeker. İstanbul, İnkılap Kitabevi, 2016.
- Skëndi, Stavro. *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*. Tiranë: Phoenix Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, 2000.

- Sönmez, Banu İşlet. *II. Meşrutiyette Arnavut Muhalefeti*. İstanbul: Yapı Kredi Yayınları, 2007.
- Swire, Joseph. *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*. Përktheu Kujtim Ymeri. Tiranë: Dituria, 2005.
- Şakir, Ziya. *Mahmut Şevket Paşa*. İstanbul: Akıl Fikir Yayınları, 2011.
- Şakir, Ziya. *İttihat ve Terakki-I Nasıl Doğdu*. İstanbul: Akıl Fikir Yayınları, 2014.
- Ramsaur, Ernest E. *Jön Türkler 1908 İhtilalinin Doğuşu*. Türkçesi: Muhsin Önal Mengüşoğlu. İstanbul: Pınar Yayınları, 2011.
- Rizaj, Skënder. “Roli i shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk të vitit 1908”. *Kosova, Enti i Historisë së Kosovës*. Prishtinë: 1974.
- Resneli, Niyazi. *Hürriyet Kahramanı Resneli Niyazi Hatıratı - Hâtırat-ı Niyazi*. Ankara: Panama yayıncılık, 2017.
- Prifti, Kristaq. *Doktor İbrahim Temo: Jeta dhe Vepra 1865-1945*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, 1996.
- Prifti, Kristaq. *Dervish Hima (1872-1928)*. Tiranë: 8 Nëntori, 1987.
- Akşin, Sina. *Jön Türkler ve İttihat ve Terakki*. Ankara: İmge Kitabevi, 2014.
- Tunaya, Tarık Zafer. *Türkiye’de Siyasi Partiler(1859-1952)*. İstanbul: Doğan Kardeş Basımevi, 1952.
- Şeyhülislam Ürgüplü Mustafa Hayri Efendi’nin Meşrutiyet, Büyük Harp ve Mütareke Günlükleri (1909-1922)*. İstanbul: İş Bankası Kültür Yayınları, 2015.
- Shaw, Stanford J. ve Shaw & Ezel Kural. *Osmanlı İmparatorluğu Ve Modern Türkiye. Cilt 2. Reform, Devrim ve Cumhuriyet: Modern Türkiye’nin Doğuşu 1808-1975*. E Yayınları: 2010.
- Temo, İbrahim. *İttihat ve Terakki Anılarım*. İstanbul: Alfa Yayınları, 2013.
- Tevfik, Ebuzziya. *Yeni Osmanlılar Tarihi. C. I. Çeviren: Ziyad Ebuzziya*. İstanbul: Kervan Yayınları, 1973.
- Tunaya, Tarık Zafer. *Türkiye’de Siyasi Partiler (1859-1952)*. İstanbul: Doğan Kardeş Basımevi, 1952.
- Tunaya, Tarık Zafer. *Türkiye’de Siyasal Partiler C. I. İkinci Meşrutiyet Dönemi*. İstanbul: İletişim, 2015.
- Türkgeldi, Ali Fuad. *Görüp İşittiklerim*. Ankara: Türk Tarih Kurumu 1951.
- Uzunçarşılı, İsmail Hakkı. “II. Meşrutiyet’in Ne şekilde İlan Edildiğine Dair Vesikalar”. *Bellekten’den ayrı basım*, Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1966.
- Uçarol, Rifat. *Gazi Ahmet Muhtar Paşa 1839-1919 Askeri ve Siyasi Hayatı*. İstanbul: Derin Yayınları, 2015.
- Vllamasi, Sejfi. *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*. Përgatitja për botim dhe ilustrimi fotografik Marenglen Verli. Tiranë: Vllamasi, 2012.

Zeyrek, Suat. “II. Meşrutiyet’te Demokratik Muhalefetin Sonu: Arnavut İsyanları ve Sonuçları”. *Erciyes Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi*, 33, 2012.

Zeyrek, Suat. *Meşrutiyet: Osmanlı’da Birlikte Yaşamak Ya da Birlikte Dağılmak (I. Dünya Savaşına Kadar)*. İstanbul: Kitabevi, 2013.

**Gazeta:**

*Sabah*, 16 Ağustos 1912.

*Tercüman-ı Hakikat*, No: 11275, 23 Ağustos 1912.

**GENTRIT SMAKAJ**

The British School of Kosova  
gentrit.smakaj@gmail.com

*S u m m a r y*

UNION AND PROGRESS COMMITTEE AND THE ALBANIANS  
IN THE YEARS 1908-1912

The announcement of the Second Constitutional Monarchy on July 23, 1908 was received with great joy and enthusiasm throughout Albania. The beginning of the Union and Progress Committee regime found the Albanians very active. Immediately after the promulgation of the constitution, national Albanian clubs were established in the main cities of Albania. The opening of many clubs in Albania, the publication of dozens of Albanian newspapers, the opening of a teacher's school in Elbasan for learning Albanian and the acceptance of Latin letters were disturbing the High Gate and in particular the Committee of Union and Progress.

The conflict between the Albanians and the Young Turk government became apparent after the counter-revolution of 1909 and the martial law process that followed. The harsh stance of the Unity and Progress Committee and its deeply wrong policies towards the Albanians turned the established cooperation between the Albanians and the Young Turks into a confrontational relationship and further fueled the Albanian nationalist uprisings. The administration of the Union and Progress Committee sent inexperienced and incompetent people as administrators to the Albanian areas, just because they were unionists. They began to implement laws that Albanians were not used to until then, saying that the basis of constitutionalism is equality, regardless of local characteristics. At the root of the problems in Albania were the consequences of extremism in the state administration. Unusual laws were

applied to the people, those who did not pay taxes were forced to pay all kinds of taxes and those who did not do military service were forced to do military service. Despite the Constitutional Monarchy, a uniform management approach everywhere made the government unpopular in the eyes of the people.